



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština Assembly
Grupi i Grave Deputete

GRUPI I GRAVE DEPUTETE



RAPORT VJETOR I PUNËS

Janar 2011 - 31 dhjetor 2011

Kontakti:
Grupi i Grave Deputete, Kuvendi i Kosovës, Kati III, nr. 319/A; Tel: 038 211 330
Web: assembly-kosova.org Email: woman.caucus@assembly-kosova.org
Janar 2012



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština Assembly
Grupi i Grave Deputete

GRUPI I GRAVE DEPUTETE



RAPORT VJETOR I PUNËS

Janar 2011 - 31 dhjetor 2011

Kontakti:

Grupi i Grave Deputete, Kuvendi i Kosovës, Kati III, nr 319/A, Tel: 038 211 330,
Web: www.assembly-kosova.org Email: woman.caucus@assembly-kosova.org
Janar 2012

GRUPI I GRAVE DEPUTETE

RAPORT VJETOR I PUNËS

Janar 2011 - 31 dhjetor 2011

Punuar nga zyra e GGD:
Sebahate Grajçevi - CBF këshilltare e GGD
Arjeta Rexhepi - asistente e GGD

Grupi i Grave Deputete - GGD

Bordi i GGD-së

1. Teuta Sahatçija (LDK) - kryetare
2. Flora Brovina (PDK) - anëtare
3. Donika Kadaj-Bujupi (AAK) - anëtare
4. Alma Lama (VV) - Anëtare
5. Suzana Novoberdaliu (KKR) - anëtare
6. Myfera Sinik (Grupi 6+) - anëtare
7. Jelena Bontić (SLS) – anëtare

Deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës

1. Afërdita Berisha-Shaqiri
2. Albana Fetoshi
3. Albana Gashi
4. Albulena Haxhiu
5. Alma Lama
6. Aurora Bakalli
7. Biserka Kostić
8. Blerta Deliu-Kodra
9. Donika Kadaj-Bujupi
10. Duda Balje
11. Emilija Rexhepi
12. Flora Brovina
13. Ganimete Musliu
14. Hasime Krasniqi
15. Hykmete Bajrami
16. Jasmina Zivković
17. Jelena Botnik
18. Justina Pula
19. Kimete Bytyqi
20. Kimete Bajraktari
21. Lirije Kajtazi
22. Lumnije Morina
23. Myfera Srbica-Sinik
24. Myzejene Selmani
25. Nazane Breca
26. Rada Trajković
27. Rita Hazeraj-Beqaj
28. Safete Hadërgjonaj
29. Sala Berisha-Shala
30. Salihe Mustafa
31. Sevdije Lama
32. Suzana Novoberdaliu
33. Teuta Haxhiu
34. Teuta Sahatçija
35. Tim Kadrijaj
36. Valbona Dibra
37. Vesna Mikić
38. Vjollca Krasniqi
39. Vjosa Osmani
40. Xhevarire Izmaku

Sebahate Grajçevci - këshilltare e GGD-së
Arjeta Rexhepi - asistente e GGD-së

Shkurtesat:

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CBF	Program i Aftësimi të Kuadrove
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
DEMI	Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
FES	Friedrich-Ebert-Stiftung
GGD	Grupi i Grave Deputete
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
KKR	Koalicioni për Kosovë të Re
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - Misioni në Kosovë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
RTK	Radio Televizioni I Kosovës
RTV-21	Radio Televizioni 21
SLS	Partia Liberale Serbe
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondacioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve
UNKT	Kombet e Bashkuara- Ekipi i Kosovës
UNWOMEN	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim për Gratë
VV	Vetëvendosje
6+	Grupi Parlamentar i Minoriteteve Jo-serbe

Hyrje

Grupi i Grave Deputete - GGD i Kuvendit të Republikës së Kosovës është grup shumë aktiv, që mbledh gratë deputete nga të gjitha grupet parlamentare dhe të gjitha nacionaliteteve.

Si grup punojmë për fuqizimin e pozitës së gruas dhe për krijimin e ambientit, ku grua do të jetë partnere e barabartë në shoqëri.

Ne besojmë se nuk mund të ketë zhvillim të mirëfilltë të demokracisë, as zhvillimin ekonomik, kulturor etj., pa pjesëmarrjen e barabartë të të dy gjinive në të gjitha proceset shoqërore, ky është edhe roli ynë për të arritur objektivat e Zhvillimit të Mileniumit – OZHM, si dhe objektivat që dalin nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian - PVPE.



GGD-ja ka mbajtur shumë: tryeza, takime, ka organizuar vizita, fushata, ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, rajonale dhe të vendit, si dhe ka zhvilluar shumë aktivitete të tjera.

GGD-ja duke pasur për qëllim të hapë diskutim për çështje me rëndësi për vendin, sidomos për gruan, ka ftuar pjesëmarrës nga: Presidenca, Parlamenti, Qeveria, Komuna, partitë politike, nga institucione dhe organizata të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare, shoqëria civile, biznesi etj., në mënyrë që të japim sugjerime dhe rekomandime, me qëllim që të ndikojmë në: përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve e në veçanti të gruas, në avancimin e pozitës së gruas, duke përkrahur atë në ngritjen e kapaciteteve intelektuale dhe profesionale, duke shikuar mundësinë e fuqizimit të saj në pozita vendosëse, në radhë të parë duke hartuar instrumente dhe duke ngritur mekanizma që e fuqizojnë atë në mënyrë përmbajtjesore.

Ne kemi gjetur një vullnet të mirë të vetë Presidentja, te Kryetari i Kuvendit, dhe gjithashtu kemi edhe shumë miq, që besojnë në atë që ne e bëjmë, dhe si rrjedhojë edhe kemi një situatë të favorshme që të bëjmë edhe më shumë për gruan.

GGD-ja, në këtë mision, ka partnerët e vet strategjikë, siç janë: NDI-ja, OSBE-ja, UNDP-ja, CBF-ja, FES-i e shumë të tjerë, që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

GGD-ja në bashkëpunim me NDI-në ka organizuar: tryeza si ajo për: Reformën Zgjedhore, Kundër Dhunës në Familje, Kundër Kancerit në Gji dhe Qafës së Mitrës, për Gruan në Biznes, debate televizive, si dhe ka organizuar, kursin e gjuhës angleze për deputetet etj.

Me OSBE-në kemi organizuar vizita takime të rëndësishme në vend dhe jashtë vendit.

Po ashtu UNDP-ja na ka përkrahur në forma të ndryshme në shumë aktivitete e tani së fundit edhe nëpërmjet CBF-së me këshilltaren për GGD-në, si dhe me ekspertin për marrëdhënie me publikun, me vizita jashtë vendit etj.

Po ashtu me FES-in kemi organizuar takime me shumë komuna ku së bashku: GGD-ja, grupet e grave asambleiste, forumet e grave të partive politike, zyrtaret, si dhe shoqëria civile nga komunat po bëjmë një punë të vlefshme për të rritur rolin e gruas në nivel lokal.

Në fund dua të theksoj se ne deputetet, pa dallim partie ose nacionaliteti, po bëjmë përpjekje që të krijojmë masën kritike të grave në vendimmarrje anekënd Kosovës. Kjo masë kritike do të inkurajojë gratë që të marrin përgjegjësi në sektorë të ndryshëm dhe jemi në rrugë të mirë që atë që ekziston në sistemet natyrore: balanca gjinore, ta arrijmë sa më shumë edhe në shoqëri.

Teuta Sahatqija
Kryetare e Grupit të Grave Deputete

Përmbledhje ekzekutive

I. Takime me:

Takimi me Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga.

Takim me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

II. Grupi i Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës

1. Amendamenti i Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës - në bashkëpunim me OSBE-në, NDI-në.
2. Dorëzimi i amendamenteve në Nënkomisionin për Mandate, Imuniteten dhe Rregullore të Punës.
3. Plani i punës së GGD-së, NDI-së, OSBE-së.
4. Hartimi i Rregullores së punës së GGD-së, NDI-së.
5. Kërkesa për hulumtim për sistemet zgjedhore në rajon – OSBE.
6. Kërkesa për hulumtim për sistemet zgjedhore, listat, zonat dhe impakti i tyre në përfaqësim gjinor - NDI – (në pritje).
7. Planifikimin e Strategjisë dhe të Planit veprues - **GGD (un-women)**.
8. Seanca - fillimi i fushatës vetëdijesuese për pozitën e femrës në shoqëri: Pozita e femrës në vendimmarrje në Kuvendin e Kosovës.
9. Seanca: Reagimi ndaj shkrimit nënçmues ndaj gruas në njëren gazetë ditore.
10. Kërkesa për përfaqësim të anëtareve nga GGD-ja në dy komisionet ad hoc: Komisionin për Reformën Zgjedhore, dhe Komisionin për Ligjin dhe Kushtetutën dhe miratimi nga ana e Kuvendit.
11. Pjesëmarrja e anëtareve të Bordit të GGD-së në komisione të ndryshme, për Rregulloren e punës së Kuvendit.
12. Seanca plenare: Reagimi lidhur me dhunën në familje i mori jetën Diana Kastratit.
13. Seanca plenare: Reagim lidhur me diskriminimin gjinor me rastin e emërtimeve të rrugëve dhe të institucioneve etj.
14. Seanca plenare, deputetet reagojnë dhe nuk e votojnë aplikimi i mësimi fetar dhe lejimin e bartjes së shamive në shkolla.
15. Seanca plenare: Reagimi kundër listës njëjgjnore e propozuar nga Qeveria për ambasador të Kosovës në disa vende.
16. Seanca plenare: Apeli i Grupit të Grave Deputete nga seanca parlamentare drejtuar të gjitha institucioneve dhe personaliteteve për ta luftuar dhunën në familje.

III. Takime me institucione dhe me autoritete ndërkombëtare, si dhe aktiviteti diplomatik i GGD-së

1. Takim me raportuesen e BE-së për Kosovë, Ulrike Lunachek.
2. Takim me ambasadorët e Kuintit në Kosovë:
 - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Christopher Dell,
 - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ian Cameron Cliff,
 - Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, Ernst Reichel,
 - Ambasadori i Republikës së Francës, Jean François Fitou,
 - Ambasadori i Republikës Italiane Michael Giffoni.
3. Pritje e vizitës nga parlamentarët e Bundestagut.
4. Takimi me përfaqësuesin e lartë të Komisionit Evropian, z. Khaldoun Sinno, lidhur me reformën zgjedhore dhe ekspertizën nga Komisioni EU-së, lidhur me

kuotën.

5. Takimi i Bordit me përfaqësues të ICO-së, Komisioni Evropian dhe eksperti i angazhuar nga Komisioni Evropian, lidhur me reformën zgjedhore.
6. Takimi me **UNDP-në**.
7. Letra nga Kabineti i **znj. Cliton**.
8. Letra nga zonja e parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës **znj. Michele Obama**.
9. Takimi me **British Council-in**.
10. Takimi me **UNICEF-in**.
11. Takimi me **deputetët nga Suedia**
12. Takimi i kryetares së GGD-së, znj. Teuta Sahatçija në selinë qendrore të **NDI-së në SHBA**.
13. Takimi i GGD-së në **Ambasadën Suedeze** - me ambasadoren e Suedisë në Kosovë, znj. Ingrid Johansson, si dhe pritje nga GGD-së në Kuvend të një grupi të deputetëve nga Parlamenti i Suedisë.

IV. Takime dhe vizita jashtë vendit

1. Shfrytëzimi i vizitës zyrtare në Bruksel për takimin e anëtareve të Bordit të GGD-së, me znj. Doris Pack. Tema e takimit kishte të bënte me reformën zgjedhore të filluar në Kosovë dhe me konsultimet për qëndrimin e BE-së lidhur me aplikimin e kuotës gjinore.
2. Deputetet Sahatçija dhe Kadaj-Bujupi marrin pjesë në **Seminarin Gratë në Politikë** në Durrës.
3. Deputetet Teuta Sahatçija dhe Suzana Novobërdaliu morën pjesë në Konferencën Rajonale të **UNDP-së** në Instanbull, lidhur me "Fuqizimin e gruas në institucione dhe partitë politike dhe aplikimi i kuotës gjinore.
4. Bordi i GGD-së shkoi në vizitë studimore në Suedie, në organizim të **OSBE-së**.

V. Tryeza tematike në përkrahje të NDI-së me të ftuar: nga Kabineti Qeveritar – kryetarë të komisioneve, deputete, personalitete kompetente nga vendi dhe jashtë vendit, për temat e trajtuara, asambleistë, forumet e grave, shoqëria civile etj.

1. Tryeza: **Reforma Zgjedhore dhe Përfaqësimi Gjinor**,
2. Tryeza: **Lufta Kundër Dhunës në Familje**.
3. Tryeza: **Lufta kundër Kancerit të Gjirit dhe Qafës së Mitrës**.
4. Tryeza: **Gratë në Biznes me titull: Pse gratë kanë nevojë për gratë**.

VI. Takime me institucione, me organizata dhe me personalitet vendore:

1. Grupi i Grave Deputete dhe Presidentja Atifete Jahjaga vizituan: **Shoqatën Medika dhe Fabrikën e Qumështit** (në përfundim) në **Gjakovë**.
2. Grupi i Grave Deputete: vizitoi Bordin e RTK-së, vërejtjet në përfaqësim gjinor nëpër debate dhe reportazhet nga Institucionet, si dhe stereotipet në media.
3. Grupi i Grave Deputete, vizitoi SOS-Fshatin e Fëmijëve.
4. Grupi i Grave Deputete pati një drekë pune me Agjencinë për Barazi Gjinore.
5. Konferenca në ABGJ - kryetarja e GGD-së, flet për rolin e gruas në proceset integruese.
6. Grupi i Grave Deputete – GGD-ja vizitoi Institutin Onkologjik.
7. Konferenca në Bibliotekën Kombëtare, e ftuar e posaçme ekspertja ndërkombëtare, znj. dr. Drude Dahllerup.

VII. Takime me grupe të grave nga asambletë komunale në bashkëpunim me FES-

in dhe OSBE-në:

1. Takimi i GGD-së me përfaqësueset e grave të Komunës së **Gjakovës**;
2. Takimi i GGD-së me përfaqësueset e grave të komunave të rajonit të **Prishtinës**;
3. Takimi i GGD-së me përfaqësueset e grave të Komunës **Istogut**;
4. Takimi i GGD-së me Grupin e Grave të Komunës së **Gjilanit**, tema: Reforma zgjedhore;
5. Takimi i GGD-së me përfaqësueset e grave të Komunës së **Vushtrrisë**.

VIII. Media:

1. Debat (mujor) i rregullt televizive “**Unë marr fjalën**” ofruar nga TV21, organizuar nga NDI
2. Konferenca për shtyp: **Lufta kundër kancerit të gjirit**;
3. Debat i televiziv tema: **Trajtimi i sëmundjes së kancerit të gjirit**;
4. Grupi i Grave Deputete mbajti **konferencë për media** lidhur me kundërshtimin e sjelljes së listës njëgjimore për ambasadorë;
5. Emision televiziv për GGD-në, nga OSBE-ja.

IX. Aktivitete të tjera:

1. Ecja për fushatën – **Lufta Kundër Kancerit të Gjirit** – aktivitet i përbashkët: Presidentja, ABGJ-ja, OJQ -VITA, Kuvendi Komunal i Prishtinës, Ambasada Franceze, UNDP-ja, dhe shoqëria civile etj.
2. Kursi i gjuhës angleze organizuar nga **NDI-ja** për Grupin e Grave Deputete.

X. Të arritura:

1. GGD pas lobimit të fuqishëm arrin ta ruaj kuotën gjinore
2. Delegacionet, në vizita jashtë vendit dhe në takime, duke filluar nga Kryesia e Kuvendit etj., kanë filluar të respektojnë përfaqësimin gjinor.
3. Është arritur të sigurohet buxhet për GGD-në nga ana e Kuvendit.
4. Përgjigje pozitive nga ministri i MPJ-së lidhur me emërimin e ambasadorëve.

MARS

Veprimtari e përbashkët e deputeteve dhe NDI-së, me rastin e 8 Marsit



Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsit, Grupi Joformal i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik - NDI, organizuan sot, në ambientet e Kuvendit të Kosovës, një veprimtari me moton “Gratë në politikë bëjnë ndryshime”, që e kryesoi Donika Kadaj-Bujupi, ndërsa krahas deputeteve dhe përfaqësueseve të

organizatave joqeveritare, merrte pjesë edhe Laura Nikols, drejtoreshë e NDI-së në Kosovë. Me këtë rast, Kathy Gest, specialiste e komunikimit dhe drejtoreshë për marrëdhënie me publikun në zyrën qendrore të NDI-së në Washington DC, mbajti një ligjëratë, në kuadër të së cilës foli lidhur me ndryshimet që gratë mund të bëjnë në politikë, duke promovuar idetë e tyre nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe modaliteteve mediale, që do t’u shërbenin për ngritjen e profilit. Me këtë rast ligjëruesja Kathy Gest, kujtoi fjalët e zonjës Madeleine K. Albright, e cila kishte thënë: “Pjesëmarrja e grave në politikë shpërfaqet me arritje të vërtetë në demokraci, duke përfshirë këtu përgjegjësinë ndaj nevojave të qytetarëve, bashkëpunim më të madh përtej kufijve partiakë dhe etnikë, si dhe paqe më të qëndrueshme”.

Në këtë tubim u tha se pjesëmarrja e grave deputete në Kuvendin e Kosovës është impresionuese, sepse kjo shkallë përfaqësimi gjendet rrallëkund në botë. Vlen të theksohet se në Legjislaturën e tashme të Kuvendit janë 40 deputete, do të thotë tri më shumë se në Legjislaturën paraprake. Trimëron fakti se në mesin e 40 grave deputete, 12 prej tyre kanë siguruar vota në shkallën e kolegëve deputetë.

Kjo veprimtari u shoqërua edhe me debate e pyetje të ndryshme rreth sfidave, që e presin këtë Grup Joformal të Deputeteve, që për nga mënyra e punës dhe e rezultateve u vlerësua si grup mbipartiak. Ndërkaq, ndër rezultatet më të mëdha të Grupit Joformal të Deputeteve, vuri në dukje deputetja Flora Brovina, është pjesëmarrja e grave deputete, sidomos në angazhimin e tyre në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve, që janë në favor të përmirësimit të pozitës së gruas në shoqëri, si: Ligji për barazinë gjinore, Ligji zgjedhor, Ligji i punës, Ligji kundër dhunës në familje, Ligji për trashëgiminë etj. Mirëpo, u tha se nuk mjafton vetëm të kemi ligje, duhet të ekzistojë gatishmëria edhe për zbatimin e tyre në praktikë.

Në këtë tubim shprehën mirënjohje për kontributin e institucioneve të ndryshme në avancimin e veprimtarisë së Grupit të Grave Deputete: NDI-ja, UNDP-ja, OSB-ja etj.

PRILL

Grupi Joformal i Grave ndërron emrin në Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës

Më 6 Prill, në ambientet e Kuvendit të Kosovës, u mbajt një mbledhje e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Flora Brovina. Gjatë këtij takimi, deputetet njëzëri vendosën ta ndërrojnë emrin e grupit, duke eliminuar fjalën “Joformale”, dhe të quhet vetëm Grupi i Grave Deputete (GGD). Ndërkaq, lidhur me zhvillimet e fundit në skenën politike, gjë që ishte edhe qëllimi i takimit, GGD dha këtë deklaratë, në të cilën thuhet:



DEKLARATË

“Deputetet e Kuvendit të Kosovës po ndjekin me vëmendje të veçantë zhvillimet e fundit të skenës politike të Kosovës.

Konstatojmë se këto zhvillime, karakterizohen nga ngërçi politik dhe nga degradimi i parimeve themelore për të cilat kemi marrë votën e qytetarëve.

Këto probleme, që janë krijuar së fundi, kanë si shkak themelor vënien e interesave partiake, dhe për më keq, të atyre personale mbi interesat e vendit.

Prandaj, ne, si përfaqësuese të popullit, i bëjmë thirrje krerëve të partive politike t’i tejkalojnë dallimet partiake dhe të shprehin vetëdije më të lartë shtetformuese.

Krizat, të cilësdo natyre qofshin ato, nuk janë në interes të Kosovës dhe të qytetarëve të këtij vendi.

Është koha të dëshmohet pjekuri politike dhe mbi të gjitha të punohet për të përbushur aspiratat demokratike, për të cilat kemi marrë besimin.

Deputetet e Kuvendit të Kosovës reagojnë gjithashtu në lidhje me arrestimet dhe përndjekjet e ish-ushtarëve të UÇK-së, përndjekje që kanë prapavijë politike me qëllim të diskreditimit të vlerave të Luftës Çlirimtare.

Këta ushtarë luftuan për të mbrojtur pragun e shtëpisë, për fëmijët dhe për familjet tona nga pushtuesi serb, nga dhuna e të cilit mbetën 15 mijë të vrarë, mijëra të zhdukur e qindra mijë shtëpi të shkatërruara. Lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe pikërisht për këtë arsye edhe NATO-ja ndërmori aksionin ushtarak.

Prandaj, i bëjmë thirrje EULEX-it të punojë në ndëshkimin e kriminelëve të vërtetë të luftës, që shkaktuan dhjetëra mijë viktima në Kosovë”, theksohet në deklaratën e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës.

MAJ

Tryezë: “Strategjia e Demokratizimit të Partive Politike”

Më 24 Maj, Grupi Joformal i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), organizuan në ambientet e Kuvendit të Kosovës, një tryezë të përbashkët pune me temë: “Strategjia e demokratizimit të partive politike”, që është një nga çështjet më parësore të Grupit të Grave Deputete. Tryezën e hapi drejtorja e NDI-së, Laura Nichols, e cila tha



se është rasti që në këtë tryezë të shtjellohen praktikat më të mira nga vende të ndryshme të botës, lidhur me demokratizimin e partive politike, gjithnjë duke pasur parasysh edhe interesimet e deputeteve të Kosovës. Pastaj fjalën e mori drejtorja e Programit të NDI-së për gratë në Uashington, zonja Susan Markham, e cila theksoi se NDI-ja që 25 vjet angazhohet gjerësisht për të kthyer besimin e qytetarëve në partitë politike. Mirëpo, kjo nuk mund të bëhet pa një demokratizim të brendshëm të partive, që do të ketë reflektim të votuesit për t’u përfshirë në aktivitetet partiake. Ndër faktorët që kanë ndikim të madh në demokratizimin e partive janë statutet e tyre, përkatësisht zbatimi i rregullave. Një element i rëndësishëm në përfshirjen më të gjerë të femrës në jetën partiake është edhe përzgjedhja demokratike e anëtarëve, theksoi ajo, sidomos transparencja, kur ka të bëjë me zgjedhjen e lidërshpit.

Gjatë debatit Teuta Sahatçija, Alma Lama e Emilia Rexhepi më shumë u angazhuan rreth çështjes së përfaqësimit gjinor, duke u nisur nga kuota prej 30 për qind të grave në përbërjen e Kuvendit. U tha se gjithnjë e më shumë kjo kuotë po konsiderohet si dhuratë e madhe dhe si privilegj, ndaj mund të jetë edhe temë me rastin e ndryshimeve kushtetuese. Në tryezë u tha se është i nevojshëm një angazhim shumë më i madh i grave që kuota e 30 përqindëshit të gjejë zbatim edhe në strukturat e partisë. Krahas kësaj gratë duhet të angazhohen edhe më gjerësisht në aktivitetet e tyre për fuqizim të mëtejshëm të pozitës së gruas në institucione dhe në gjithë rrjedhat shoqërore.

Nga: Seanca parlamentare

Anëtarja e Bordit të GGD, znj Alma Lama reagoi lidhur me dhunën në familje, që i mori jetën Diana Kastratit

Transkripti

E premte, 27 maj 2011

KRYETARI: Faleminderit, deputete Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë

Një krim shumë i rëndë ndodhi para pak ditësh në mes të kryeqytetit të Kosovës, në mes të ditës dhe në mes dhjetëra kalimtarëve, Diana Kastrati, 27 vjeçare, nënë e një fëmije, u qëllua për vdekje nga ish-bashkëshorti. E gjithë shoqëria është tronditur nga kjo vrasje e shëmtuar, të gjitha gratë, nënat dhe motrat janë të indinjua me apatinë e organeve të rendit për të arrestuar dorasin.

Vrasja e Dianës nuk është një krim individual, por është një krim i përbashkët i një bashkëshorti vrasar dhe i një gjykate të papërgjegjshme, që nuk ndërmori masat parandaluese në kohën e duhur. Dhe, kjo e bën edhe më të rëndë këtë tragjedi.

Mungesa e vëmendjes së organeve të drejtësisë, që dështuan të parandalojnë këtë krim, është e pafalshme. Gjykata Komunale e Prishtinës nuk ishte përgjigjur pozitivisht kërkesës së Dianës për t'i dhënë asaj mbrojtjen e nevojshme për jetën. Ky refuzim i bërë me kaq lehtësi, nuk është gjë tjetër, veçse mungesë përgjegjshmërie dhe profesionalizmi, por njëkohësisht është edhe mungesë ndjeshmërie njerëzore. Çfarë mund të jetë më e rëndësishme në punën e një polici, prokurori ose gjyqtari, sesa të marrë në mbrojtje një jetë njerëzore? Asgjë.

Sot kur po flasim, janë me qindra gra ose me mijëra raste të raportuara në polici, ku gratë janë viktimat të dhunës në familje. Por, qindra gra të tjera që përjetojnë dhunë psikologjike dhe fizike, hezitojnë t'i drejtohen këtij institucioni, pikërisht për shkak të mungesës së besimit. Dhe, rasti i Dianës vetëm sa ua ka konfirmuar dyshimin në organet e sigurisë dhe të drejtësisë. Vrasja e Dianës do t'i dekurajojë me dhjetëra ose me qindra gra të tjera për të kërkuar mbrojtje nga shteti.

Sot në Kosovë janë me dhjetëra gra që nuk do të dëshironin gjë tjetër në jetë, veçse të gjenin një strehë ku të fusnin kokën e të largoheshin një herë e mirë nga ferri i dhunës ku jetojnë.

Sot në Kosovë janë me qindra fëmijë të cilët rriten në një ambient që garanton vetëm një të ardhme për ta, atë të prindërve të tyre.

Sot në Kosovë, gruaja nuk ka të garantuar as minimumin, pra jetën. Do të ishte ironi të flisnim tani për diskriminimin e saj në shoqëri, në institucione, në vendimmarrje, në ekonomi e të tjerë.

Rasti fatkeq i Dianës duhet të na shërbejë të gjithëve për t'u treguar më të vëmendshëm për dhunën në familje, në radhë të parë duhet të jetë një kampion alarmi për institucionet e drejtësisë, për vendimet e së cilës peshojnë me jetë njerëzish.

Lëvizja "Vetëvendosje!" kërkon nga Ministria e Drejtësisë dhe nga institucionet që emërojnë dhe kontrollojnë punën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të tregohen më të përgjegjshëm dhe të heqin dorë nga emërimet politike dhe nga retorika e zbrazët, dhe të angazhohen seriozisht për të ndërtuar një gjyqësor të pavarur dhe të nivelit të lartë profesional. Në të kundërt, rasti i Dianës do të na përsëritet sërish dhe krime të tjera të shëmtuara do të ndodhin, sa kohë që kriminelët nuk e ndiejnë frikën e ndëshkimit.

Faleminderit!

Grupi i Grave Deputete zgjodhi kryetaren e GGD-së

Më 27 Maj 2011,

Gratë deputete të Kuvendit të Kosovës (40 veta, nga të gjitha subjektet politike), në kuadër të funksionalizimit të Grupit të Grave Deputete, sot zgjodhën Bordin e këtij Grupi dhe kryetaren e tij.

Ato fillimisht zgjodhën Bordin prej gjashtë vetave, pastaj edhe kryetaren. Pas një votimi të fshehtë, Teuta Sahatçija, mori besimin e grave deputete dhe u zgjodh kryetare e Bordit.

Kryetarja e re, duke falënderuar kryetaren e mëparshme, Flora Brovina, për punën e deritashme, u zotua për bashkëpunim të ngushtë me të gjitha gratë deputete.



QERSHOR

Grupi i Grave Deputet propozoi amendamente për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

E martë, 7.06 2011

Grupi i Grave Deputet analizoi Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe pas një pune të përbashkët të deputeteve, me qëllim të funksionalizimit dhe të demokratizimit të mëtejshëm të punës së Kuvendit propozoi këto amendamente, që i hartoi, i propozoi, i arsyetoi dhe u angazhua në emër të GGD-së që të përkrahen.

Këto amendamente u përkrahen dhe u nënshkruan nga 61 deputetë të grupeve dhe të nacionaliteteve të ndryshme.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Kuvendi - Skupština – Assembly
 Grupi i Grave Deputete



PËR: Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës

Kryetarit: Z. Armend Zemaj

NGA: Grupi i Grave Deputete

LËNDA: Propozimet për amendamentet në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës

Data: 07.06.2011

I nderuari Kryetar,

Ju lutem t'i gjeni të bashkangjitura propozimet për amendamentet në Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës të punuara nga Grupi i Grave Deputete.

Amendamentet kanë për qëllim respektimin e aspektit gjinor, si në gjuhën e përdorur, gjithashtu edhe në përfaqësim gjinor nëpër trupat e Kuvendit, duke e respektuar Ligjin për barazi gjinore të miratuar po në këtë Kuvend.

Besojmë se këto amendamente do të ndihmojnë në demokratizimin e punës në Kuvend, njëherësh do të reflektojnë edhe në demokratizimin në partitë politike dhe në shoqëri.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj Ju përshëndesim.

Me respekt,
Teuta Sahatçija
 Kryetare e Grupit Grave Deputete
 Kuvendi i Kosovës
 Kati III, nr. 319 A
 E-mail: woman.caucus@ks-gov.net
 woman.caucus@gmail.com
 Tel: 038 211 330

Neni 1 (shënim: në nenin e parë të shtohet pika e 3-të).

3. Në këtë Rregullore respektohet përfaqësimi gjinore në të gjitha trupat vendimmarrëse të Kuvendit dhe në delegacionet parlamentare.

Nënkryetarët e Kuvendit

Neni 7 (16) shënim: shtohet një fjali në pikën e dytë dhe shtohet pika e katërt)

në pikën 2 dhe shtohet:

Partia, koalicioni, nga i cili vjen Kryetari i Kuvendit, duhet të propozojë kandidat për nënkryetar të gjinisë së ndryshme nga ajo e Kryetarit.

shtohet pika 4 si vijon:

4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga Grupi i Grave Deputete të propozojë një kandidate për nënkryetare, e cila do të përfaqësojë me rotacion Grupin e Grave Deputete.

Neni 14 (17) ndryshon si vijon:

Kryesia e Kuvendit përbëhet nga Kryetari dhe nga gjashtë (6) nënkryetarët.

Formimi i grupeve parlamentare

Neni 19 (23) të shtohet një fjali në pikën e parë

1. **Deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose të orientimit politik dhe sipas interesit të veçantë, siç janë Grupi i Grave Deputete, Grupi i Deputetëve të Rinj në moshe etj.**

Në pikën 2 të shtohet:

2. *Deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas interesit të veçantë, si Grupi i Grave Deputete dhe Grupi i Deputetëve të Rinj në moshë.*

Në pikën 3 të shtohet fjala 'politik' në pikën 3)

3. Për krijimin e një grupi parlamentar kërkohet një minimum prej gjashtë (6) deputetësh. Deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një grupi parlamentar politik.

Kryesimi i grupit parlamentar Sigurimi i kushteve të punës për grupet parlamentare

Neni 20 (24) shënim: të kthehet pika e parë e këtij neni)

1. Çdo grup parlamentar, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryetarin e tij dhe zëvendëskryetarin, të cilët nuk duhet të jenë të së njëjtës gjini.

(shtohen fjalët më ngjyrë të verdhë)

2. Grupeve parlamentare Grupit të Grave dhe Grupit të Deputetëve të Rinj u sigurohen mjediset e pune, stafi, buxheti dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e tyre.

Neni 23 (28) Përbërja e komisioneve të Kuvendit shënim: në pikën 3 shënohet si vijon:

3. Përbërja e komisionit parlamentar, reflekton fuqinë politike të grupeve parlamentare dhe për aq sa është e mundur edhe barazinë gjinore.

Shtohet edhe pika e katërt

4. Kryetari dhe nënkryetarët e komisioneve nuk duhet të jenë të gjinisë së njëjtë.

Dhe pika 4 bëhet 5 dhe pika 5 bëhet 6

Neni 24 (30) (shënim: shtohet pika 2 e këtij neni)

Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve të Kuvendit

1. Grupet parlamentare propozojnë kryetarët, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e komisioneve në përputhje me marrëveshjen e arritur në Konferencën e Kryetarëve. Në marrëveshjen për caktimin e posteve për kryetarë të komisioneve, Konferenca e Kryetarëve merr parasysh numrin e deputetëve që ka çdo grup parlamentar.
3. Të gjitha komisionet duhet të kenë nga dy zëvendëskryetarë: zëvendëskryetarin e parë dhe zëvendëskryetarin e dytë, që u përkasin grupeve të ndryshme parlamentare. Së paku njëri nga zëvendëskryetarët duhet të jetë i komunitetit tjetër nga ai i kryetarit.

Takim i Bordit të: GGD-së me Bordin e RTK-së

E enjte, 09.06.2011

Grupi i Grave Deputete, në kuadër të aktiviteteve për fuqizimin e rolit të gruas në politikë dhe në shoqëri zhvilloi një takim me Bordin e Radiotelevizionit Publik. Në këtë takim u bisedua në lidhje me përmirësimin e pasqyrimin të angazhimit të grave në mediumin publik. “Aktualisht ky pasqyrim është i varfër dhe ka diskriminim në baza gjinore”, tha kryetarja e Bordit të Grupit të Grave Deputete, Teuta Sahatçija, duke kërkuar që të sigurohet hapësira e mjaftueshme dhe e barabartë për të dyja gjinitë.



Anëtarja e Bordit të Grave Deputete, Donika Kadaj Bujupi, tha se televizioni publik duhet të jetë i kujdesshëm në hapësirën në lajme dhe në debate televizive, në mënyrë që gratë të jenë të ftuara dhe të japin mendimin e tyre në lidhje me proceset që zhvillohen në vend. Ndërsa deputetja Alma Lama theksoi se roli i medias është i jashtëzakonshme në zhvillimin e shoqërisë dhe se i takon televizionit publik. Ai duhet të fillojë të luajë rolin e promotorit të vlerave, ku një vend të rëndësishëm duhet të zënë gratë që u përkasin të gjitha fushave të jetës.

Drejtori i Bordit të RTK-së, Rrahman Paçarizi, u shpreh i gatshëm për bashkëpunim dhe premtoi se RTK-ja do të ndërmarrë masa të menjëhershme për të përmirësuar pasqyrimin e punës së gruas në media dhe mbi të gjitha të largimit të stereotipeve që ekzistojnë në shoqërinë e Kosovës.

Ai kërkoi që RTK-ja të përkrahet nga Kuvendi dhe nga Grupi i Grave Deputete, që janë në një format mbipartiak, si në aspektin e plotësimit të kuadrit ligjor, ashtu edhe për ruajtjen e pavarësisë editoriale, që është thelbësore për punën e gazetarëve.

Kryekuvendari Krasniqi priti Bordin e Grupit të Grave Deputete

E martë, 14.06.2011

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në një takim Bordin e Grave Deputete, të kryesuar nga kryetarja e Bordit, Teuta Sahatçija. Takimi zhvillohej në kuadër të aktiviteteve për fuqizimin e rolit të gruas në politikë dhe shoqëri nga ana e Grupit të Grave Deputete. Teuta Sahatçija tha se edhe Bordi i ri ka plane ambicioze në ngritjen e punës së Kuvendit dhe në fushën e demokratizimit. “Gjatë punës sonë do të jemi grup i përkushtuar i deputeteve për të vepruar mbi interesat partiake drejt fuqizimit të rolit të gruas, por njëkohësisht do të jemi bashkë me të gjithë deputetët për të punuar e për të bashkëpunuar në detyrat më aktuale që na presin”, tha Sahatçija.



Gjatë bisedës anëtarët e Bordit theksuan se puna e mirë që është bërë në dy mandatet e kaluara nga Grupi i Deputeteve duhet të fuqizohet. U vunë në pah angazhimet që po bëhen për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, në frymën e sensibilizimit nga aspekti gjinor, si dhe për përfaqësim më të denjë të grave deputete në trupat e Kuvendit, si: në Kryesi, në komisione, si dhe në grupet parlamentare. Për të arritur këto plane deputetët kërkonin përkrahje edhe nga kryetari i Kuvendit, duke pohuar faktin se ai edhe deri tash ka përkrahur aktivitetet e grave deputete. Shih për këtë Bordi i Grave Deputete e ftoi Kryekuvendarin të jetë anëtar i parë nderi i Grupit të Grave Deputete.

Kryekuvendari premtoi mbështetjen e aktiviteteve të Grupit të Grave deputete përtej përfaqësimeve politike, duke u zotuar se do të shikohen të gjitha mundësitë që gratë deputete të ndihmohen në të gjitha angazhimet e tyre. Në këtë vështrim ai premtoi mbështetje edhe sa i përket sigurimit të hapësirës së punës, por edhe të shqyrtimit të mundësive për përkrahje materiale. “Kontributi juaj është i rëndësishëm sidomos në dhënien e ideve gjatë ndryshimeve në procesin e zgjedhor, përkatësisht reformës zgjedhore, punë kjo që po bëhet nga ana e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë. Në këtë vështrim, në kuadër të përfaqësimit të gruas, duhet të angazhoheni edhe për ruajtjen e kuotës së 30 përqindëshit në përbërjen e Kuvendit”, theksoi Kryekuvendari Krasniqi. U vlerësua njëzëri se secila e drejtë e fituar duhet të ruhet dhe të avancohet, dh jo të reduktohet.

Grupi i Grave Deputete priti përfaqësues të Bundestagut të Gjermanisë

E premte, 24.06.2011

Grupi i Grave Deputete i Kuvendit të Kosovës, i prirë nga kryetarja Teuta Sahatçija, e shoqëruar nga deputetja Alma Lama e Donika Kada-Bujupi, priti sot përfaqësues të Bundestagut Gjerman.



Duke u uruar mirëseardhje, Sahatçija fillimisht i njoftoi mysafirët për angazhimin e grave deputete në Kuvendin e Kosovës, për nismat e tyre në afirmimin e të drejtave të grave dhe për sfidat në realizimin e qëllimeve që kanë ato.

Lidhur me këtë, kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Sahatçija, i njoftoi mysafirët se Kuvendin e Kosovës e përbëjnë 120 deputetë, nga të cilët dyzetë nga ata janë gra. Ajo më tej sqaroi se sipas Ligjit për zgjedhjet, që aktualisht është në fuqi, pjesëmarrja në Kuvend e grave është e garantuar në kuotën prej 30%. Sahatçija shtoi Kosova është duke ndërtuar një infrastrukturë të re ligjore lidhur me zgjedhjet, andaj angazhimet e Grupit tonë janë të ruhet kuota e përfaqësimit dhe shtimi i saj. Lidhur me këtë, ajo njoftoi mysafirët se janë formuar dy komisione parlamentare për amendamentimin e Ligjit për zgjedhje dhe për ndryshimet kushtetuese. “Në të dyja komisionet janë të përfaqësuara edhe gratë, sepse reformat zgjedhore dhe kushtetuese do të përcaktojnë rolin e gruas dhe pjesëmarrjen e saj në vendim-marrje”, tha Sahatçija.

Ndërkaq, deputetja Donika Kada- Bujupi, në fjalën e saj u fokusua në objektivat që synon të arrij Kosova. “Qëllimi ynë, i burrave e grave në Kosovë, është anëtarësimi në familjen e madhe të BE-së”, tha ajo. Bujupi me këtë rast shprehu edhe falënderimin e saj për interesimin dhe ndihmën që ka treguar Gjermania ndaj Kosovës në të gjitha proceset e deri tashme.

Anëtarja tjetër e Grupit të Grave Deputete, Alma Lama, ndërkaq, duke iu referuar përvojës së mëhershme si gazetare, vuri në pah se situata e rëndë ekonomike në Kosovë është duke gjeneruar probleme të shumta. “Për fat të keq, vazhdoi Lama, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike zë vend edhe dhuna në familje”.

Ajo më tej shtoi se në këto raste, gruaja është ajo që bart pasojat më të rënda të kësaj gjendjeje. Edhe deputetja Lama falënderoi Gjermaninë, për siç tha ajo: “Qëndrim realist ndaj realitetit ballkanik”.

Nga ana tjetër, Inge Hoger, në emër të delegacionit nga Gjermania, duke falënderuar nikoqiret për pritjen e ngrohtë, foli për qëllimin e vizitës. “Dëshironim të dimë si janë të organizuara gratë në Kosovë dhe si u shkon puna si deputete”, tha znj. Hoger. “Në Gjermani, vazhdoi ajo, s’ka grup të caktuar të grave në Bundestag, sepse ato përfaqësohen në kuadër të partive përkatëse.” Përfaqësuesja e Bundestagut, Hoger, u pajtua me konstatimin se gjendja ekonomike gjeneron probleme të shumta, dhe shtoi se ky është problemi më i madh që ka aktualisht Ballkani. Në vijim, znj. Hoger, inkurajoi gratë deputete për punën këmbëngulëse në krijimin e kushteve për jetë më të mirë të gruas në Kosovë. “Keni bërë punë shumë të madhe dhe vazhdoni të avanconi të drejtat tuaja si dhe rolin tuaj në vendimmarrje”, tha përfaqësuesja e Bundestagut Gjerman, Hoger.

Grupi i Grave Deputete vizitoi SOS-Fshatrat e Fëmijëve



E hënë, 27.06.2011

Me rastin e javës së SOS-Fshatrave të Fëmijëve dhe me qëllim të ngritjes së vetëdijes së shoqërisë sonë për të mbrojtur dhe për të përkrahur fëmijët pa përkujdesje prindërore, Grupi i Grave Deputete realizoi një vizitë në këto fshatra për të parë si të përkrahen fëmijët e braktisur dhe ata fëmijët pa përkujdesje prindërore në Kosovë.

Me këtë rast, deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, patën rastin të dëgjonin më shumë për këtë kategori të shoqërisë, duke u fokusuar më shumë në aspektin e infrastrukturës ligjore. Nezahat Salihu, drejtore Kombëtare e SOS-Fshatrave të Fëmijëve të Kosovës, në fjalimin e saj hyrës u është drejtuar deputeteve: “Këta fëmijë nuk janë vetëm të SOS-it, por janë të gjithë Kosovës” dhe kërkoi që ato të jenë zëri i SOS-it në Parlament.

Gjatë prezantimit janë prekur edhe disa çështje që i përkasin ligjeve, që janë në fuqi dhe që rregullojnë shumë aspekte të përkujdesjes së fëmijës.

Një ndër ligjet që kërkohet nga deputetët për ndryshim dhe për plotësim është edhe Ligji mbi të ardhurat e korporatave, sepse ai nuk inkurajon kompanitë që të japin donacione për qëllime humanitare, sepse atyre me këtë rast nuk u jepet ndonjë lehtësim.

Po ashtu si ligje të rëndësishme të kësaj fushe janë përmendur edhe Ligji për vullnetarë dhe Ligji për sponsorizim.

Teuta Sahatçija, kryetare e Grupit të Grave Deputete, duke iu drejtuar punëtorëve të SOS-it tha: “Puna juaj nuk është e lehtë. Kjo punë duhet të përkrahet nga institucionet e vendit dhe ne, si deputetë, do të punojmë për të rregulluar problemet të cilat u paraqitën e që kanë të bëjnë më fëmijët e braktisur” .

Me moton “PAK NGA JU, VLEN SHUMË PËR MUA” SOS-Fshatrat e Fëmijëve kanë filluar javën e fushatës tradicionale për ngritjen e vetëdijes së shoqërisë dhe mbledhjen e fondeve, që do të zgjasë prej datës 23 deri më 29 qershor 2011.

SOS -Fshati i Fëmijëve në Kosovë vepron që nga viti 1999. Deri më sot, përmes katër projekteve, SOS -Fshatrat e Fëmijëve janë përkujdesur për rreth 1000 fëmijë të braktisur dhe në rrezik për braktisje.

Grupit të Grave Deputete gjatë vizitës në Bruksel

Doris Pack mbështet kuotën gjinore dhe listat e hapura:

E premte, 25.06.2011.

Përfaqësuese të Bordit të Grupit të Grave Deputete gjata vizitës në Bruksel kanë zhvilluar edhe një takim me deputet e Parlamentit Evropian, zonjën Doris Pack. Në takim është biseduar për punën e Kuvendit të Kosovës, me theks të veçanta në lidhje me angazhimin e Grupit të Grave në përmirësimin e përfaqësimit gjinor.

Në takim morën pjesë, Teuta Sahatqija, kryetare e Bordit të Grupit të Grave Deputete, si dhe anëtarët e Bordit: Alma Lama , Donika Kadaj, Vjosa Osmani, si dhe anëtare të tjera të delegacionit.

Gjatë takimit u fol edhe në lidhje me ndryshimin e ligjit zgjedhor me të cilin po merret një komision i caktuar nga Kuvendi. Zonja Pack, pasi iu informua për problematikën rreth këtij ligji, shprehu mbështetjen e plotë në lidhje me ruajtjen dhe respektimin e kuotës gjinore, si dhe për listat e hapura të cilat sigurojnë një shkallë më të gjerë demokracie, duke iu mundësuar zgjedhësve të votojnë për emrat të cilëve iu besojnë.

Grupi i Grave Deputete, gjatë vizitës në Bruksel i ngriti këto çështje edhe në takime të tjera me zyrtarë të lartë të Komisionit Evropian, si mr. Lawrence MEREDITH, mr. Ruud VAN ENK. ms. Jana SINDEKOVA , ms. Anna-Maria- Eleni BOURA dhe mr. Jonas JONSSON, ku gjithashtu mori mbështetje të plotë.

KORRIK

GGD angazhohet për kuotën

Takim i Grupit të Grave Deputete me ekspertë evropianë

E mërkurë, 06.07.2011

Bordi i Grupit të Grave Deputete, i kryesuar nga kryetarja Teuta Sahatqija, kishte sot një takim me ekspertë të Komisionit Evropian, ICO-së dhe të OSBE-së, gjatë të cilit u bisedua rreth reformës zgjedhore, shikuar nga vështrimi i pjesëmarrjes së gruas në zgjedhje dhe përfaqësimit



të tyre në institucionet e vendit. Në fillim të takimit ekspertët Nikolai Vulchanov dhe Karin Marmsoler nga Komisioni Evropian, folën për praktikën e ndryshme të zgjedhjeve në vende të ndryshme evropiane e botërore, duke iu referuar edhe konventave ndërkombëtare mbi zgjedhjet dhe barazinë gjinore. Ata paraqitën alternativa të ndryshme sa i përket aplikimit të listave të hapura dhe listave të mbyllura, si dhe kuotës së përfaqësimit të grave në përbërjen e Kuvendit.

Ne debatin e gjerë që pasoi pas këtyre fjalëve, si kryetarja, ashtu edhe anëtarët e Bordit, theksuan se kanë qenë të gjata e këmbëngulëse përpjekjet dhe aktivitetet e grave për përmirësimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare, e në këtë kuadër edhe të përfaqësimit sa më të denjë të gruas në Kuvend dhe institucione të tjera të vendit. Diskutueset ishin për lista të hapura dhe ruajtjen e kuotës së 30 përqindëshit, por njëkohësisht kërkonin që gratë të kenë hapësirë sa më të gjerë, që me votën e drejtpërdrejtë të sigurojnë vend në parlament. Këto rezultate të arritura, të cilat Kosovën e bëjnë lider në rajon, janë arritur me shumë mund, ndaj edhe duhet të ruhen, theksonin ato. Mirëpo, vërejtjet e tyre kishin të bënin më hapësirën që duhet t'iu jepet femrave në të gjitha proceset, si: në fushatën zgjedhore, në media etj., ku vazhdimisht mbizotërojnë meshkujt, sidomos liderët. Theksohej se në procesin zgjedhor në Kosovë nuk është problem kuota, por mënyra se si mbahen zgjedhjet. Në këtë frymë diskutueset kërkonin një mbikëqyrje më të madhe të procesit zgjedhor nga ana e institucioneve përkatëse, në mënyrë që të evitohen parregullsitë dhe manipulimet gjatë zgjedhjeve. Në këtë vështrim nuk janë problem listat e hapura apo të mbyllura dhe as kuota, por çështje është se a po zhvillohen zgjedhjet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht sa janë ato imune nga parregullsitë?

Takim i Grupit të Grave Deputete me Presidenten Atifete Jahjaga



7 korrik 2011

Bordi i Grupit të Grave Deputete- GGD u takua me Presidenten e vendit, Atifete Jahjaga. Kryetarja e GGD-së Teuta Sahatqija njoftoi Presidenten me punën dhe angazhimin e GGD- së në Kuvendin e Kosovës, për aktivitetet e GGD, me qëllim që ta fuqizojnë më shumë rolin e gruas, në radhë të parë duke i zbatuar instrumentet vendore dhe ndërkombëtare, si konventa CEDAW, Ligji për Barazinë Gjinore etj, por edhe nevojën që edhe ligjet e tjera të trajtohen nga perspektiva gjinore. Deputetet theksuan nevojën e implementimit sa më të lartë të Ligjit për Barazi Gjinore, jo vetëm në mënyrë kuantitative, por edhe duke insistuar dhe vendosur gruan në pozita të larta vendim-marrëse. Presidentja duke i përgëzuar deputetet për punën e mirë që po e bëjnë siguroi deputete se kur është fjala për ngritjen e nivelit të demokratizimit të vendit që arrihet duke përfshirë të dy gjinitë ajo gjithmonë do t'i përkrahë dhe nuk do të nënshkruajë dhe dekretojë as dokumente, e as pozita të cilat nuk janë në favor të barazisë gjinore.

GGD lobon për kuotën gjinore

Letër e Grupit të Grave Deputete drejtuar Ambasadorëve të Quint-it në Kosovë

Kryetarja e GGD, znj. Teuta Sahatqija në emër të GGD-së i drejtohet me një letër me këtë përmbajtje Ambasadorëve të Quintit në Kosovë:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly
Grupi i Grave Deputete

Honorable Ambassador

Date: 06.07.2011

I am writing on behalf of the Parliamentary Women's Caucus and am pleased to invite you for a meeting with the Quint Ambassadors any time during the week of 18 July 2011.

The reason for this meeting is to discuss our concerns related to the ongoing constitutional and electoral reform, in particular, the tendency to close the lists and to remove the legislative gender quota.

As you are aware, open lists have enhanced democracy in Kosovo and have given the voters the opportunity to have a direct impact in the democratization of the parties, and the gender quota has had an important influence in the empowerment of women in decision making. Thus, it is our strong belief that any decision to the contrary would undermine Kosovo's state-building and democracy-building process. Kosovo has been internationally recognized as one of the best examples globally with respect to its gender quota, and we have shown the positive impact of this example with the election of our President, as the first woman President in the region.

Looking forward to meet you soon in person to discuss these issues, please accept, Mr. Ambassador, the assurances of my highest esteem and consideration.

Teuta Sahatqija
 Women Caucus President

Tryezë lidhur me Reformën Zgjedhore



E premte, 15.07.2011

Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me NDI-në, mbajti sot një tryezë lidhur me reformën e Ligjit zgjedhor, në të cilën mermin pjesë kryetarët e komisioneve për reformën zgjedhore dhe të atij për ndryshimet kushtetuese, përkatësisht Haki Demolli e Arsim Bajrami, si dhe deputetë, përfaqësues të partive politike, të forumeve të grave, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Tryezën e udhëhoqi Alma Lama, ndërsa fjalën hyrëse e paraqiti Teuta Sahatqija, kryetare e Bordit të Grave Deputete. Në fillim të fjalës së vet zonja Sahatqija theksoi se Grupi i Grave Deputete angazhohet për fuqizimin e gruas në politikë dhe në segmentet e tjera të jetës institucionale e shoqërore, mbi interesat partiake, të vetëdijshme se të gjitha gratë ballafaqohen me probleme të njëjta. Forcimi i demokracisë, tha ajo, nuk është i mundshëm pa pjesëmarrjen e gruas në të gjitha proceset shoqërore, pra edhe në vendimmarrje. Me gjithë rezultatet e arritura, u shpreh Sahatqija, edhe më tutje gratë nuk mund të jenë të kënaqura me përfaqësimin e tyre në qeverisje dhe vendimmarrje, duke e ilustruar këtë edhe me të dhëna përkatëse. Një vështrim të gjerë aktivitetit të grave deputete, i bëri deputetja Flora Brovina, e cila theksoi se kuotën duhet ta kemi vetëm si një ndihmesë, ndërsa duhet të krijohet hapësirë e nevojshme që gratë me aftësitë e tyre të ballafaqohen në garën zgjedhore, në mbarë aktivitetet, për t' u zgjedhur edhe nga vota e drejtpërdrejtë.

Haki Demolli dha një pasqyrë të gjerë të aktiviteteve të Komisionit për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke theksuar se ky komision brenda 12 muajve duhet të përfundojë amendamentimin në Ligjin mbi Zgjedhjet. Ky Komision, tha ai, ka formuar edhe grupin punues, ndërsa të gjithë janë të përqendruar veçanërisht në tri drejtime: identifikimin e problemeve zgjedhore, organizimin e debateve, si dhe draftimin e Ligjit dhe procedimin në kohën e planifikuar në Kuvend.

Duke folur për punën e Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Arsim Bajrami, tha se pas largimit të dy presidentëve për shkak të shkeljeve kushtetuese u pa e nevojshme që presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Në këtë mënyrë arrihet që presidenti të përfaqësojë unitetin dhe njëkohësisht sigurohet legjitimiteti i zgjedhjes së presidentit, neutraliteti i tij dhe stabiliteti i vendit, pasi presidenti dhe kryeministri do të zgjidhen ndaras. Për herë të parë, tha Bajrami, Kosova do të ketë Ligj zgjedhor për zgjedhjen e presidentit.

Deputetja Donika Kadaj foli për aktivitetet e Grupit të Grave Deputete, sidomos sa i përket takimeve të këtij grupi me përfaqësues të subjekteve të ndryshme nga vendi dhe Evropa, ndërkaq drejtorja e NDI-së, Laura Nichols tha se ky subjekt do të ofrojë mbështetje në shumë aspekte, por sidomos me analiza komparative në këtë lëmë.

Në debatin e gjerë u tha se Grupi i Grave Deputete, si dhe të gjitha asociacionet e grave duhet të shtojnë angazhimet e tyre, që në kuadër të reformës zgjedhore të gjenden mënyrat e zgjidhjet sa më adekuate, të cilat do të reflektonin në përmirësimin e mëtejshëm të pozitës së gruas në qeverisje dhe vendimmarrje. Në këtë frymë, megjithatë, kuota e 30 përqindëshit shihej si një zgjidhje tash për tash e pazëvendësueshme, ndërsa duhet të kihen parasysh propozimet e reja që bëhen, për të peshuar mirë e mirë se çfarë efekte do të prodhojnë.

Përfundime kryesore të tryezës ishin respektimi i kuotës dhe listat e hapura. Ndërkaq, përfundime të tjera të rëndësishme të tryezës dhe për të cilat u pajtuan njëzëri të gjithë pjesëmarrësit ishin: votimi i më shumë se një kandidati, funksionimi dhe forcimi i gjyqësorit, i cili do të ishte garant i respektimit të ligjit për zgjedhje, respektimi i ligjit për barazi gjinore në nivelin 40% në të gjitha institucionet, përmirësimi i aspektit teknik dhe rritja e transparencës, si dhe buxheti gjinor, i cili është esencial për implementimin e ligjeve të cilat adresojnë barazinë gjinore.

Si nevojë urgjente u adresua edhe demokratizimi i brendshëm i subjekteve politike, të cilat janë çelës i zhvillimit të demokracisë.

Takimi i Bordit të Grave Deputete me raportuesen e BE-së për Kosovë, zonjën Ulrike Lunachek

E martë, 19.07.2011

Teuta Sahatqija, kryetare e Grupit të Grave dhe anëtarët e Bordit, Flora Brovina dhe Donika Kadaj -Bujupi, u takuan sot me znj. Ulrike Lunachek, raportuese e BE-së për Kosovë, me të cilën biseduan për aktivitetin e GGD-së, për punën në grave në Parlament, në partitë politike, institucione dhe në përgjithësi në shoqërinë kosovare. Theksi i veçantë i bisedës u vu në fillimin e reformës zgjedhore dhe në angazhimin e gruas në procesin e reformës. Në takim u shpreh brenga për ruajtjen e kuotës gjinore në sistemin zgjedhor me zona.



Ato shprehen besimin se me fuqizimin e gruas në institucione dhe shoqëri krijohet ambienti për demokratizimin e shoqërisë sepse, prania e gruas e rritë seriozitetin dhe punën dhe ul mundësinë për korrupsion dhe abuzime.

Zonja Lunachek tha se grua duhet të ketë pozitën e saj në institucione dhe të ketë rol të rëndësishëm në proceset nëpër të cilat kalon Kosova, dhe se fuqizimi i gruas është një prej prioriteteve të BE-së.

Letër Sekretares, Clinton

E mërkurë, 20 korrik 2011

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Teuta Sahatqija, me qëllim të sensibilizimit të autoriteteve ndërkombëtare lidhur me potencialin e gruas së Kosovës për të kontribuar në rritjen në nivel më të lartë, demokratizimit të vendit, i cili do të sigurohet së pari duke organizuar zgjedhje të mira dhe duke i siguruar gruas rolin që e meriton i drejtohet me një letër zonjave me ndikim në politikën ndërkombëtare. Letra e poshtë shënuar e cila i është dërguar: Sekretares së Shtetit të SHBA, znj. Hillary Clinton, me të njëjtën përmbajtje Ju është dërguar edhe: Ish-Sekretares së Shtetit të SHBA, znj. Madeleine Albright, znj. Melanne Vermeer Ambassador-at-Large for Global Women's Issues, dhe znj. Michelle Obama, zonja e parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly
Grupi i Grave Deputete

Honorable Secretary Clinton:

It is an honor to write to you on behalf of 40 Women MP's of the Assembly of the Republic of Kosovo and of over 50 percent of the Kosovo population consisting of women.

The Republic of Kosovo is going through very crucial times and is now working on constitutional and electoral reforms. The past few elections, despite many challenges, were successful and productive in one regard: women empowerment. The Assembly of the Republic of Kosovo applies a 30 percent quota for women representation. An example of how this quota has influenced the empowerment of women in politics and other representative positions is the fact that only compared to the last mandate, the number of women who got in as MP's without the quote increased for 50 percent. In addition, it was thanks to the votes of women in Parliament (despite political party affiliation), that the institutional crisis of electing a President was overcome, and as a result, Kosovo is now represented by the first woman President, Mrs. Atifete Jahjaga, who is the first woman President in the region.

We understand and are inspired by Obama Administration's increased interest and elevated importance for Global Women's issues, and in particular, Your personal role in empowering women and girls across the globe. It is precisely the same prin-

principles that we are guided by in our important, but challenging goal of representing women and providing concrete support to women's rights and their political, social and economical advancement. The Kosovo society and institutions still have a long way to go with respect to women's rights, and an attestation to that is the fact that only 2% of women in our country can exercise their property rights.

It is for that reason, that we are asking for Your support, in keeping the 30 percent quota representation for women in the Kosovo Assembly. The Women Parliamentary Caucus is highly dedicated to being a strong and efficient voice for all the women of Kosovo, regardless of their ethnic community or social status. While the electoral reform in Kosovo is ongoing, we are concerned about the tendency to remove the 30% women quota and apply closed lists for parliamentary elections. Both these actions would undermine democracy and would allow political parties, rather than the people, to be the only decision-making power in choosing the next representatives of the people of Kosovo.

The United States of America has supported Kosovo in each and every step of its state and democracy building process. We count on Your support for this important objective which touches upon the life of each and every woman in Kosovo.

Sincerely,
Teuta Sahatqija
Chair of Kosovo Women's Parliamentary Caucus

Reagim i anëtares së Bordit të GGD-së, Flora Brovina lidhur me diskriminimin gjinor me rastin e emërtimeve të rrugëve dhe institucioneve etj.

Transkripti nga Seanca plenare

E enjte, 21 .07. 2011

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Unë flas edhe në emër të Grupit të Grave Parlamentare.

Më lejoni, zoti kryetar, të nderuar kolegë dhe kolege. Tema për të cilën do të flas sot, sigurisht që është aktuale gjithnjë pas luftës, edhe pse sot kemi disa tema të tjera, që ndoshta ia marrin aktualitetin, zbatimi i Ligjit për barazinë gjinore dhe pikërisht në emërimin e shkollave dhe rrugëve, në kohën kur po emërohen këshillat për emërimin e rrugëve dhe të shkollave të reja gjatë këtij fillimi të vitit shkollor që fillon në shtator. Në bazë të një studimi që u dha para disa ditësh, u konstatua se duke e konsideruar kontributin e gruas gjatë kohës në arsimim, në shëndetësi, sidomos kontributin e saj në bërjen e lirisë së Kosovës dhe ndërtimin e pavarësisë edhe sakrificën e saj të shumtë gjatë kësaj kohe, gratë nuk janë të përfaqësuara në emërimin e rrugëve dhe të institucioneve kulturore, arsimore krahas kontributit të tyre. Nga 576 shkolla fillore në Kosovë, vetëm 10 ose 02% mbajnë emrat e grave të shquara. Në shkollat e mesme vetëm 15 ose 17%, duket pak më mirë, por në numër fare pak janë. Aspak më mirë nuk qëndron situata në emërimin e rrugëve, ta zëmë në kryeqytetin tonë nga 477 rrugë, vetëm 16 mbajnë emrat e grave të shquara ose 3% : në Ferizaj 8%, në Prizren 4%, në Gjilan 6%, në Mitrovicë 7%, në Gjakovë 5%, madje ka raste sikur është rasti në Gjakovë kur emri i rrugës, emëruar, domethënë, të një gruaje të shquar për kontributin e saj dhe rezistencën e saj gjatë periudhave të ndryshme, ndërrohet me një emër, natyrisht të shquar të një burri. Këto të dhëna le të flasin vetë dhe të dëshmojnë se gruaja nuk është respektuar sa duhet sa i përket emërimit të rrugëve, nuk është respektuar sakrificat dhe kontributi i saj kombëtar, natyrisht edhe kontributi në të gjitha lëmit që i përmenda. Unë për t'i kontribuar ekipeve që punojnë në emërimin e rrugëve në komuna dhe emërimit të shkollave, do t'i përmend disa emra për ... (Ndërrpreje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Hajt përmendi, regjia!

FLORA BROVINA: Atëherë: Shote Galica, Xheve Lladrovci, Hyre Emini, Katarina Josipi, motrat Qirijazi, Marie Shllaku, Ganimet Tërbeshi, Zahide Jashari, Rukie Beqiri, Fatime Krasniqi, Ylfete Humolli, Shukrie Obërtinca, Sadete Mekuli, Nëna Ajshe-Gërvalla, Bije Vokshi, Hyrie Hana, gratë e Baliqit të Ferizajit, Marrshi i Bukës ose Marrshi i Grave për Drenicën, deputetja Gjini nga Mitrovica, pastaj gratë që pajtuan gjaqet: Myrvete Maksutaj, Edit Durham, Merlin Olbrajt, Elena Gjika, Misine Kokollari, Marie Kraja, Natasha Kandiç, Sonja Biserko, gratë në të zeza të Beogradit, që u ngritën kundër mbylljes së shkollave dhe kundër luftës në Kosovë: Doris Pack, Kristin Folcon, Eva Bentley, Melihate Ajeti, Xhanfise Keko dhe sigurisht do t'i përmend gratë e Qirezit, vajzat e Qirezit, që u hodhën në pus dhe shumë, Yllka Domi dhe shumë emra të tjerë, që do t'ua dorëzojmë komunave veç e veç. Faleminderit!

Grupi i Grave Deputete takoi ambasadorët e Quint-it

E premte, 22.07.2011

Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës zhvilloi një takim me ambasadorët e Quint -it të akredituar në Prishtinë. Temë e takimit ishte njoftimi i ambasadoreve në lidhje me angazhimin e Grupit të Grave për ndryshimet e ligjit zgjedhor. Kryetarja e Grupit të GGD-së, Teuta Sahatçija, pasi i njoftoi ambasadorët në lidhje me punën e Grupit, që pas konstituivit të tij, tha se qëndrimin e Grupit të Grave janë mbështetja e listave të hapura dhe ajo e kuotës gjinore, si dy elemente të demokracisë në një vend në tranzicion që është Kosova. Deputetja Flora Brovina tha se vendet e rajonit po e marrin pikërisht ligjin zgjedhor të Kosovës me lista të hapura dhe një zonë zgjedhore, si shembull të mirë të demokracisë. Ndërsa deputetja Alma Lama theksoi se problem nuk ka qenë ligji si i tillë por zbatimi i tij. Zgjedhjet e 12 dhjetorit janë çështje e shkeljes së ligjit dhe për ta përmirësuar situatën duhet të forcohet sistemi i drejtësisë. Nga deputetja Donika Kadaj -Bujupi u ngrit problemi i forcimit të autoritarizmit të liderëve politikë, në rast se do të mbështetet modeli i listave të mbyllura.



Ambasadorët e Quint-it, ku bënte pjesë-, Chistofer Dell SHBA, Jean. Francoic Fitou (France), Ian Cliff (Britani Madhe) dhe Michael Giffoni (Itali) i dhanë përkrahje të plotë punës së Grupit të Grave dhe qëndrimeve të tyre në lidhje me ligjin zgjedhor dhe fusha të tjera të angazhimit.

Sekretarja Clinton përmes ambasadorit Reeker i përgjigjet letrës së GGD- së

E nderuara Znj. Sahatçija

Faleminderit për letrën tuaj që së fundit ia keni dërguar Sekretares znj. Clinton, me qëllim që të siguroni se reforma e sistemit zgjedhor nuk do të zvogëlojë përfaqësimin e grave në Kuvendin e Kosovës. Sekretarja kërkoi nga unë që t'iu përgjigjem dhe që të ju sigurojë se fuqizimi –politik, social dhe ekonomik i grave –është gurëthemel i politikës së jashtme të SHBA- ve, pikëpamje që ajo e theksoi kur ajo u takua me gratë në tetorin e vitit të kaluar në Prishtinë. Gratë në Kosovë po bëjnë hapa te mëdhenj, ndoshta keni dhënë shembullin më të mirë me zgjedhjen e Presidentes, znj. Atifete



Jahjaga, në muajin prill dhe ky veprim ka rritur shpresat dhe inspiron gratë dhe vajzat në tërë rajonin. Ne besojmë se procesi i reformës zgjedhore do të ofrojë shans për të zgjeruar edhe më shumë fuqizimin e gruas në politikë. Qëllimi është që të ketë një sistem elektoral të drejtë dhe transparent, por gjithashtu edhe që të sigurojë edhe grave vend të rëndësishëm në Kuvendin e Kosovës dhe në diskutimet legjislative- në diskutime në të cilat, ato luajnë rol të rëndësishëm në ndërtimin e shoqërisë së hapur, demokracisë multi-etnike, vënien e themeleve për sektorin privat që shpjen drejtë rritjes ekonomike, dhe sigurojnë që Qeveria e Kosovës dhe shoqëria kosovare të jenë të bazuara në sundimin e ligjit.

Siç e dini, ambasada jonë në Prishtinë ka punuar afër dhe drejtpërdrejt me Grupin e Grave Deputete në reformat zgjedhore aq shumë të nevojshme, dhe ne do të vazhdojmë të ju përkrahim në punën tuaj, të madhe, në veçanti në çështjet si kuotat gjinore dhe listat e hapura.. Meqë Grupi i Juaj, ka dëshmuar, që është i aftë të punojë përmes linjave partiake, që është vetë avokati më i mirë, kështu që ne ju inkurajojmë që të bëni maksimumin dhe të shfrytëzoni çdo mundësi për ta realizuar kauzën tuaj. Ne do të vazhdojmë, përmes programeve të USAID- it, të ofrojmë ndihmë të drejtpërdrejtë Grupit të Grave Deputete, si në punën tuaj në procesin reformës zgjedhore, si dhe në çështjet që GGD i adreson në interes të gruas dhe shoqërisë.

Përpjekjet tuaja që të krijon hapësirë në Kuvend për të gjithë zërat- zërat e grave, të rinjve, të minoriteteve, për ide të reja, për zgjedhje të reja- janë shumë me rëndësi për Kosovën. Ne do të vazhdojmë që të punojmë me ju për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për grat e Kosovës.



United States Department of State

Washington, D.C. 20520

August 23, 2011

Teuta Sahatqija, Chair
Women's Parliamentary Caucus
Assembly of Kosovo
Pristina
Republic of Kosovo

Dear Ms. Sahatqija:

Thank you for your recent letter seeking Secretary Clinton's support in ensuring that the ongoing electoral reforms in Kosovo do not diminish women's representation in the Assembly of Kosovo. The Secretary asked me to respond and reassure you that women's empowerment – political, social, and economic – is a cornerstone of U.S. foreign policy, a point she underscored when she met with women leaders last October in Pristina.

Women in Kosovo are making great strides, perhaps best exemplified by the April election of President Atifete Jahjaga, which has given hope and inspiration to women and girls throughout the region. We believe the electoral reform process offers a chance to further expand women's political empowerment. The goal must be a fair and transparent electoral system, but also one that ensures women a prominent place in the Kosovo Assembly and in legislative deliberations – deliberations that play a critical role in building an open, multi-ethnic democracy, laying the foundation for private sector-led economic growth, and ensuring Kosovo's government and society are firmly grounded in the rule of law.

As you know, our Embassy in Pristina has worked closely and directly with the Women's Parliamentary Caucus on the much-needed electoral reforms, and we will continue to support your hard work, particularly on the issues of gender quota and open lists. Your group, because of its demonstrated ability to work across partisan lines, is its own best advocate, so we encourage you to do your utmost to seize every opportunity to advance your cause. We will continue, through USAID-funded programs, to provide direct assistance to the Women's Parliamentary Caucus, both in your work in the ongoing electoral reform process, and as the Caucus addresses other issues important to women and society.

Your efforts to create space in the Assembly for all voices – the voices of women, of youth, of minorities, for new ideas, and for new solutions – are very important to Kosovo. We look forward to continuing to work with you as you build a better future for the women of Kosovo.

Yours sincerely,

Philip T. Reeker
Ambassador
Deputy Assistant Secretary
for South Central Europe

GUSHT

Seanca plenare; Projektligji për Arsimin Para-universitar në Republikën e Kosovës

Deputetet reagojnë dhe nuk i votojnë amendamentet 7 dhe 8, në të cilët kërkohej aplikimi i mësimit fetar dhe lejimi i bartjes së shamive në shkolla.



***Material i marr nga transkriptimi, 29 gusht 2011**

TEUTA SAHATQIJA: Kryesues, ky amendament thotë: "Institucionet shkollore publike dhe private duhet të përmbahen nga çdo lloj i diskriminimit fetar ose etnik, si dhe përhapja e urrejtjes ndërfetare dhe etnike". Nenet 21 dhe 22, të Kushtetutës sonë flasin jashtëzakonisht qartë për parimet e përgjithshme, për të drejtat dhe liritë themelore, ku thuhet se Kushtetuta dhe Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat. Në qoftë se në amendament thuhet që duhet të përmbahen nga çdo lloj diskriminimi, atëherë po fitohet përshtypja që në shkollat tona ekziston diskriminimi ndër-fetar ose etnik.

Përkundrazi, mendoj që në popullin tonë, është popull ndoshta unik, në të cilin toleranca ndërfetare është tolerancë, ku duhet të merret shembull. Prandaj, mendojmë që ky nen përkundrazi nuk krijon përmbajtje nga diskriminimi, por tregon që aty ka diskriminim dhe që me ligj mbi Kushtetutë duhet të rregullohet. Kjo është e rregulluar me Kushtetutë dhe Kushtetuta është mbi çdo ligj edhe mendoj që kjo nuk e ka vendin këtu.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, kryesues!

Mendoj që në këtë debat, fjala prejardhja prej majmunit ose komunizëm e tjera, nuk kanë vend. Jemi duke biseduar për një temë shumë të rëndësishme dhe duhet të jemi në nivel.

Po të kishte qenë këtu komunizëm, ajo as nuk kishte ardhur në pyetje për të diskutuar për këtë, prandaj duhet të kemi respekt për këtë Kuvend që po debaton. Tjetër. Vetë fakti që është hapur një debat që nuk ka konsensus në mes të konfesioneve, tregon që ky debat është i hershëm dhe çfarëdo pune e hershme, sjell fryte të cilat nuk mund të ndikojnë pozitivisht. Ky debat është i hershëm, nuk ka konsensus në mes të konfesioneve fetare, e pamë reagimin edhe të Kishës Katolike dhe të tjerëve, prandaj mendojmë që neve si shoqëri na duhet shumë më tepër kohë që të zhvillohemi, e pastaj të diskutojmë për te. Është debat i hershëm dhe ky amendament në këtë Kuvend nuk e ka ende vendin.

KRYESUESI: Faleminderit!

TEUTA SAHATQIJA: Viteve '60 ka pasur më së paku vetëvrasje, e tjera, e tjera. Viteve '60 nuk ka pasur edukatë fetare, sa e di unë. Prandaj, nuk mundet me vetëvrasjet të arsyetohen me kërkesën për futjen e lëndës mësimore. Në qoftë se lënda fetare na bën më të mirë, e jo hipokritë, mendoj që ekzistojnë gjërat e tjera, kurrikule të tjera, ekzistojnë lëndë të tjera, ekziston sistemi shkollor, i cili duhet të ketë shumë më tepër vëmendje, se sa që morali shoqëror të rregullohet me ligj. Përsëri po kthehet në atë pse e lypa replikën? Ekziston mungesa e konsensusit. Para se të dalë kjo, si amendament, do të duhej që të ketë një mirëkuptim në mes të konfeksioneve. Ai mirëkuptim nuk ekziston, prandaj edhe një herë po e potencoj, është herët sepse ekziston mungesa e konsensusit atje jashtë dhe nuk mundemi këtu ta përkrahim, se është para kohe.

KRYESUESI: Ju

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Pajtohem se ky debat ka marrë... domethënë është degjeneruar dhe ka marrë një rrjedhë që nuk i përshtatet këtij Parlamenti dhe nuk i konvenon këtij Parlamenti. Parlamenti i Kosovës, është e vërtetë që nuk është interpretues i Kushtetutës, por ai mbron Kushtetutën e Kosovës. Dhe, në këtë ne nuk jemi mjaft të zëshëm duke e mbrojtur Kushtetutën. Kushtetuta thotë se Kosova është një shtet laik, ku të drejtat fetare të gjithëve ju garantohen, edhe me ligje. Jo vetëm në Ligjin për fenë, por edhe në Ligjin kundër diskriminimit, ku hyn edhe diskriminimi fetar. Askush, asnjëherë, pra, nuk ka tentuar që feve të ndryshme në Kosovë, që për fat janë të shumta dhe nuk janë vetëm 3, sepse çdo ditë po lindin fe të reja, ju garantojmë këtë të drejtë, por ky amendament, sigurisht e shkel Kushtetutën e Kosovës dhe thashë se është shtet laik dhe tenton që të shkel, të intervenohet edhe në Ligjin për arsimimin parauniversitar. Prandaj, gjithashtu ky ligj dhe në bazë të diskutimit që u dha në interpretimin e këtij amendamenti, sigurisht që shkelen edhe të drejtat e grave. Këtu u tha se prostitucioni është zhvilluar në këtë kohë të demokracisë. Unë nuk mund të pajtohem në asnjë mënyrë me këtë thënie të ekspertit që e njeh edhe psikologjinë, pra, edhe psikiatrinë e njeriut shumë mirë, profesor. Sepse, prostitucioni mund të zhvillohet dhe nuk e dimë sa është i zhvilluar edhe nën shami dhe në perçe, edhe unë jam... e di edhe unë profesionalisht këtë.

Nuk do të hyj në këtë debat më tutje, sepse nuk e kam qëllimin ta degjeneroj, por mos t'i ndajmë këto çështjet me moralin, fenë dhe edukatën e shoqërisë tonë. Kujtoj se ne duhet ta mbrojmë. Unë bashkohem me të gjithë intelektualët e Kosovës se ne na duhet fuqizimi i gruas dhe pjesëmarrja e saj më e fuqishme institucionale, arsimiti i saj më i denjë dhe jo mbulesa e fytyrës dhe shamia në shkolla. Nëse ato duan të marrin edukim fetar, i kemi shkollat fetare, dhe gjithashtu mund të orientohemi andej. Aq më tepër që ky amendament, është deklaruar konfesionit tjetër, pra, katolik që sjellë përçarje dhe nuk është marrë një mendim i përbashkët që feja të futet si mësim në shkollat parauniversitare dhe gjithashtu të futet edhe veshja e caktuar për femrat. Faleminderit!

DONIKA KADAJ - BUJUPI: I nderuar kryesues,

S'e kisha marrë fjalën, se me të vërtetë vetë fakti që një amendament i tillë ka ardhur këtu në Kuvend, nga një grup që nuk përfaqëson as një për qind të qytetarëve të Kosovës, e që këtu ministri del edhe thotë unë i përfaqësoj 90% të besimtarëve të Kosovës. I keni huqur matematikat! Ju nuk përfaqësoni shumicën e qytetarëve të Kosovës në këtë Kuvend dhe nuk keni të drejtë të manipuloni me fjalë. Të paktën të jeni

të saktë në atë që e thoni. Të gjithë të tjerët e dinë që nuk është vullnet i qytetarëve të Kosovës, as shamia, as flamuri i zi në qendër të Prishtinës, të cilin e keni ngritur. Edhe gjyshet tona kanë luftuar kundër asaj çka ju sot po kërkonit të instaloni në Kosovë, e përmes të cilës po i bëni shumë dëm kombit. E dimë që shqiptarët e kanë një komb, që është para fesë dhe ai komb është shqiptaria. Edhe sot ju kisha lutur të gjithë deputetëve të këtij Kuvendi që mos të dëmtojnë edhe më tutje interesin kombëtar dhe shtetëror të Kosovës. Kosova shumë moti e ka marrë një drejtim dhe të gjithë e dimë drejtimin e Kosovës, që është properëndimor, proevropian dhe ajo çka po kërkonit ju, as nuk është perëndimore, as evropiane, e aq më pak demokratike. Prandaj, mos manipuloni më tutje dhe, ju lutem, mos e fryni më tutje këtë Kuvend duke u ngritur dhe duke thënë që flisni në emër të 95% të qytetarëve të Kosovës, se nuk flisni, ju nuk përfaqësoni as 1% të qytetarëve të Kosovës dhe rastësisht gjendeni këtu ku gjendeni.

Prandaj, i nderuar kryesues, ju lutem që ta hedhim në votim, ta marrim një vendim dhe ta mbyllim sot këtë kapitull, se me të vërtetë po degradohet edhe Kuvendi. Po i torturojmë edhe qytetarët e Republikës së Kosovës me këto fjalime, që nuk janë as të vërteta, as të sakta, as në emër të tyre. Faleminderit. KRYESUESI: Faleminderit!

SHTATOR

GGD - Hartoi Strategjinë e Veprimit

9 deri 11 shtator

GGD në përkrahje nga UNDP dhe UNIWOMEN, në bashkëpunim edhe me Forumet e Grave të Partive Politike hartoi draftin e parë të Planit strategjik të GGD-së. Punëtorja u zhvillua për tri ditë rresht në Prevallë.

Nga CBF sigurohet një këshilltare për GGD- në

E hënë, 12 shtator

Znj. Marta Gazideda nga CBF njofton Bordin e GGD se do t'i përkrahin duke i siguruar një këshilltare, lidhur me realizimin e objektivave që dalin nga pika: 116 e PVPE, që ka të bëjë me ngritje në nivel më të lartë zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore. Për këtë objektiv CBF përkrah GGD-në, me këshilltaren Sebahate Grajçevci.

Teuta Sahatqia u takua me këshilltaren e lartë për çështje gjinore nga UNDP, znj. Jocelyne Talbot

E premte, 16.09.2011

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, znj. Teuta Sahatqia, u takua sot me këshilltaren e Lartë për çështje Gjinore nga UNDP, znj. Jocelyne Talbot, ekspertin për koordinim me OKB, znj. Nora Loxha-Sahatçiu, si dhe drejtorin e projekteve(PSDP) nga UNDP z. Selim Selimi, me të cilët u diskutua për gjetjen e modaliteteve adekuate për ngritjen



e shkallës së përfshirjes së gruas në të gjithë sektorët e jetës, si dhe dinamizmin e trajtimit të çështjeve gjinore. Znj. Sahatqia theksoi rolin e rëndësishëm të UNDP-së dhe UNKT-së në zhvillimin e kapacitetit të GGD-së për t'i adresuar dhe trajtuar çështjet gjinore në mënyrë përmbytësore. UNDP dhe UNKT do të përkrahin Grupin e Grave Deputete në hartimin e Strategjisë dhe një Plani të Veprimit gjithëpërfshirës për aplikimin e kuotës gjinore, me qëllim të sigurimit të përfaqësimit të gruas dhe fuqizimit të saj në pozita vendimmarrëse.

Në takim u theksua roli i deputeteve të Kuvendit të Kosovës në trajtimin e ligjeve, draftimin, monitorimin dhe buxhetimin e tyre duke pasur parasysh gjithmonë edhe perspektivën gjinore, në favor të avancimit të funksionimit të demokracisë në institucionet qeveritare dhe në të gjitha nivelet tjera.

UNDP dhe UNKT, duke konstatuar se ka nevojë të promovohet më tepër puna e deputeteve, premtuan përkrahje për deputetet, sidomos në lëmin e marrëdhënieve me publikun, komunikimin me mediat, organizimin e konferencave etj. Në veçanti këto organizata do të angazhohen të promovojnë efektet pozitive që ka sjellë aplikimi i kuotave, fuqizimi i pozitës së gruas, si dhe rëndësia e vazhdimit të këtij procesi, i cili do të shtojë vlerat civilizuese në shoqërinë kosovare.

Grupi i Grave Deputete në kursin e gjuhës angleze

E mërkurë, tetor 2011

Grupi i Grave Deputete të përkrahura nga NDI tani po vijojnë kursin e gjuhës angleze



Deputetet Sahatqija dhe Bujupi marrin pjesë në Seminarin Gratë në Politikë në Durrës



E mërkurë, 21.09.2011

Deputetet e Kuvendit të Kosovës, Teuta Sahatqija dhe Donika Kadaj- Bujupi, me ftësë të organizatës suedeze "Kvin ti Kvin", po marrin pjesë në seminarin për avokim që po mbahet në Durrës, organizuar me temën: Gratë në Politikë - vendimmarrje dhe kuota gjinore në Kosovë.

Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me atë se pse Kosova ka nevojë për kuota gjinore, si mund të rritet numri i pjesëmarrjes së femrave në vendimmarrje, çfarë

mund të bëjnë politikanet dhe çfarë mund të bëjë shoqëria civile në këtë aspekt, si mund të rritet bashkëpunimi ndërmjet tyre?

Gjate këtij debati Teuta Sahatqija tha se Kosova ka pasur shumë zgjedhje me sisteme të hapura, të mbyllura, me kuotë vetëm në listë, ose kuota obligative, me një, pesë ose dhjetë përzgjedhje dhe dihet shumë mirë efekti i secilës prej tyre. Është me rëndësi të vendosim se cilat janë kërkesat dhe prioritetet tona, a kërkojmë demokratizim dhe mundësi për përzgjedhje me konkurrencë si në listat e hapura, ose kërkojmë demokratizimin e shoqërisë përmes përfaqësimit të gruas.

Sa i përket çështjes së kuotës legislative në nivelin parlamentar dhe komunal, nuk mund të diskutohet për heqje të saj, por vetëm për avancim. “Në anën tjetër, ne besojmë se përfaqësimi i duhur i gruas ose fuqizimi i saj mund të bëhet me instalimin e kuotës nëpërmjet ndryshimeve statutare në çdo strukturë të partive politike”, theksoi Sahatqija.

Deputetja Donika Kada -Bujupi theksoi se përvojat ndërkombëtare tregojnë se klasat politike nuk lëshojnë pe në raport me krijimin e hapësirës për gra dhe të rinj, prandaj politikat afirmative janë domosdoshmëri për të thyer stereotipat, në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta për gjithë përfshirje, sidomos për gratë, të cilat dita ditës po dëshmojnë kualitet të lartë në punën e tyre, si lidere në politikë dhe në përgjithësi në jetën publike.

Në Kosovë edhe pse me shume sfida, dekada e fundit ka dëshmuar se kuota ka sjellë ndryshim në kuptimin pozitiv të pjesëmarrjes së gruas në Kuvend dhe në Qeveri. Po kështu, edhe zgjedhja e Kryetares së parë në rajon ka reflektuar një imazh më të mirë për Kosovën, si vend demokratik që ecën drejt integritimeve evropiane, që është objektiv i Kosovës. Çdo e drejtë e fituar duhet avancuar, e jo kundërta.

Grupi i Grave Deputete u takuan me Grupin e Grave të Komunës së rajonit të Gjilanit

E mërkurë, 5 tetor 2011

Grupi i Grave Deputet në vazhden e takimeve me Grupet e Grave të komunave të Kosovës, sot u takuan me Grupin e Grave të rajonit të Gjilanit. Në këtë takim deputetja Donika Kada -Bujupi foli për rolin e rëndësishëm që ka sot gruaja në procesin e zhvillimit të demokracisë dhe në procesin drejt integritimit në BE. Proces i cili varet edhe nga roli dhe fuqizimi i gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e shoqërisë. Donika Kada- Bujupi foli për reformën zgjedhore, rëndësinë që Kosova të ketë zgjedhje të besueshme dhe demokratike, si dhe rëndësinë e aplikimit të kuotës gjinore, legislative në Ligjin zgjedhor në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore, si dhe rëndësinë e përfshirjes së Gruas edhe më tutje në pozita ku ndikimi i saj është i rëndësishëm dhe në favor të politikave gjinore. Edhe Grupet e Grave nga Gjilani shprehen shqetësimet e tyre lidhur me moszbatimin e ligjit për Barazinë Gjinore, e madje edhe me një formë të diskriminimit të fshehtë që po ndodh në punësim, ose zgjedhje në pozita më të larta. Nga ky takim u rekomandua që:

- Në Reformën Zgjedhore të aplikohet kuota gjinore legislative, konform Ligjit për Barazinë Gjinore,

- Të amendamentohet Ligji për Barazi Gjinore dhe të rritet zbatueshmëria e tij në mënyrë kualitative,
- Ligji për Partitë Politike të përfshijë kuotat gjinore obligative të cilat duhet t'i aplikojnë në aktet normative të tyre,
- Të rritet roli i gruas në kuvendet komunale duke fuqizuar mekanizmat gjinor ekzistues, si Grupet e Grave të komunave, Zyra për Barazi Gjinore.
- Në politikat arsimore të përfshihet perspektiva gjinore, si dhe të investohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe intelektuale të grave.

Tryezë e Grupit të Grave Deputete mbi dhunën në familje

E mërkurë, 19.10.2011

Dhuna në familje dhe parandalimi i saj ishte temë qendrore e tryezës, të organizuar nga Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga Teuta Sahatqija, kryetare e Bordit të GGD-së, e ku mermin pjesë edhe presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, drejtorja e NDI-



së në Kosovë, Laura Nichols, Avokati i Popullit të Kosovës, Sami Kurteshi, deputetë dhe veprimtarë të institucioneve të ndryshme, që merren me mbrojtjen e të drejtave të gruas.

Duke iu drejtuar të pranishmëve, presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, theksoi se dhuna ndaj gruas e trondit dhe e shkatërron trungun e familjes. Dhuna si e tillë bëhet pengesë për jetë me dinjitet të gruas, por njëkohësisht bëhet pengesë edhe për prosperitet të shoqërisë. Dhuna, tha ajo, është dukuri e shëmtuar globale, ndaj duhet të luftohet me veprime konkrete për t'u çrrënjësuar nga shoqëria, meqë nuk mund të ketë tolerancë ndaj dhunës kundër gruas dhe fëmijëve. Ajo i siguroi pjesëmarrësit se do të ketë përkrahjen e saj si presidente për luftimin e kësaj dukurie. Presidentja Jahjaga u angazhua për angazhim drejt krijimit të një ambienti të shëndoshë për fëmijë, në familje dhe në shkollë, ashtu si veprohet edhe në shoqëritë e civilizuar evropiane.

Në fjalën përshëndetëse Laura Nichols, drejtore e NDI-së tha se dhuna në familje ndodh në çdo cep të botës, ndaj kërkohet përkushtim për luftimin e saj. Kjo luftë duhet të jetë prioritet i lartë. Luftimit të kësaj dukurie, NDI-ja i kushton kujdes të madh, ndërsa "kur jemi së bashku, kur punojmë kështu, jemi më të fortë, atëherë edhe do të arrijmë rezultate.", theksoi ajo.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, në fillim theksoi se dhuna në familje është një nga temat më të rënda në shoqëri, pasi gruaja është

strumbullar i shoqërisë. Qeveria e Kosovës në kuadër të prioritetit për rend dhe ligj angazhohet edhe për mbrojtje të grave dhe fëmijëve nga dhuna. Është tragjike, tha ai, që gjysma e rasteve ndaj të cilëve ushtrohet dhunë, janë gra dhe fëmijë. Duke folur për nevojën e ndërmarrjes së masave parandaluese kundër dhunës, Hajredin Kuçi, u angazhua për krijimin e një ambienti, në të cilin nuk



do të ekzistojë dhuna. Është e nevojshme, tha ai, që edhe më shumë të punohet në aspektin rehabilitues të grave dhe fëmijëve që kanë përjetuar dhunën. Ndërkaq, raportimi i secilit rast të dhunës në familje është faktor me rëndësi reflektuese në zvogëlimin e kësaj dukurie. Mirëpo, për këtë është i nevojshëm edhe guximi dhe ndihma juridike. Nëse veprohet kështu, atëherë tha ai, zbehet guximi për të ushtruar dhunë. Në kuadër të luftimit të dhunës në familje, Qeveria e Kosovës angazhohet e kontribuon edhe në fushën e përpilimit të ligjeve përkatëse. Në këtë vështrim ai përmendi nevojën e shkurtimeve të procedurave nëpërmjet Kodit Penal për marrjen masave përkatëse ndaj personave që ushtrojnë dhunë, në mënyrë që brenda dy seancave gjyqësore të përmbillet kapitulli i rastit të dhunës në familje.

Avokati i Popullit të Kosovës, Sami Kurteshi, foli për rolin dhe kontributin që mund të japë ky institucion në luftimin e kësaj dukurie, e cila sipas tij është e shprehur veçanërisht në mjediset rurale. Pos dhunës fizike, ai theksoi edhe dhunën psikike ndaj gruas, e cila shkakton trauma psikologjike me pasoja edhe për fëmijët.

Përkitazi me angazhimet e Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe për persona të pagjetur në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit foli deputetja Albana Gashi, e cila theksoi sa ka pengesa gjatë zbatimit të këtij ligji. Diskutuesit vunë në spikamë faktin brengosë se raportimi i rasteve të dhunës në familje nuk shoqërohet edhe me angazhim efikas të organeve të ndjekjes. Madje, u përmend edhe një rast kur pikërisht për shkak të neglizhencës së organeve të ndjekjes para do kohe një grua është vrarë, megjithëse ishte raportuar rasti. U tha se sipas shënimeve statistikore ka rënë numri i raportimeve për dhunë në familje, por vështirë është të vlerësohet se a thua është kjo pasojë e asaj se vërtet ka rënë ky numër, ose qytetarët kanë humbur besimin te institucionet përkatëse dhe nuk e shohin të arsyeshme të raportojnë rastet në polici. Gjatë debatit doli edhe propozimi për ngritjen e një programi të integruar për reagim në rastet e raportuara, përkatësisht që raportimet të mos mbeten çështje vetëm e viktimave dhe policisë.

Letër: nga zonja e parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Michel Obama dërguar kryetares së GGD- së, znj. Teuta Sahaqija

THE WHITE HOUSE
WASHINGTON

October 24, 2011

Ms. Teuta Sahaqija
United States Embassy Pristina
9520 Pristina Place
Washington, D.C. 20521

Dear Ms. Sahaqija:

On behalf of the First Lady, I would like to thank you for your letter.

It is my understanding that the United States Department of State has already responded to your inquiry. Thank you again for writing to the Office of the First Lady. Mrs. Obama sends you her best wishes.

Sincerely,



Howli J. Ledbetter
Director of Correspondence
Office of the First Lady

Debat televiziv në RTV 21 “Lufta kundër Kancerit të Gjirit”



E hënë, 31 tetor 2011,

Ishte debati në RTV-21. Në të u diskutua për Luftën kundër kancerit të gjirit. Në debat ishin prezent Kryetarja e GGD-së, Teuta Sahatqija, dhe anëtarja e Bordit të GGD-së, Flora Brovina, si dhe Naser Ramadani, Drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Mejreme Maloku, drejtore Ekzekutive e Institutit Onkologjik. Muaji tetor ka qenë i karakterizuar me shumë aktivitete kundër Kancerit të Gjirit, kështu e filloi Teuta Sahatqija debatin. Ajo tregoi që në bashkëpunim me shoqatën Jeta Via kanë organizuar Marshin e mbajtur një ditë më parë, etj.

Konferencë për shtyp “Fushata, kundër kancerit të gjirit”

E martë, 1 nëntor 2011

Në kuadër të fushatës kundër kancerit të gjirit, Grupi i Grave Deputete ka kërkuar të hënën nga Qeveria që të ndajë mjete buxhetore për trajtimin e kësaj sëmundje, e cila për çdo vit sa vjen e rritet. Deputetet theksuan se kjo sëmundje shkakton vdekshmërinë e shumë grave në Kosovë, për shkak të mos lajmërimit me kohë dhe kushteve jo të mira për diagnostikim.



Kanceri i gjirit është një nga sëmundjet me vdekshmërinë më të lartë për gratë, për shkak se kjo sëmundje në vendin tonë kapet në stadi të avancuara. Edhe pse nuk ka statistika zyrtare, sipas disa të dhënave, një në dhjetë gra preket nga kanceri i gjirit në vendin tonë.

Deputetja Flora Brovina tha se në vendin tonë mbetet problem mungesa e kushteve, laboratorëve dhe pajisjeve adekuate për trajtimin e kësaj sëmundje. Ajo shfaqti brengën se edhe preventiva është lënë pas dore dhe shtroi si nevojë rregullimin ligjor që gratë e prekura nga kanceri i gjirit të kenë mbështetje institucionale

NËNTOR

Grupi i Grave Deputete, në organizim të British Council u takua me një delegacion të përbërë nga personalitete të rëndësishme nga pesë vendet evropiane që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

E martë, më 01.11.2011

Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, është takuar sot me një delegacion të British Council, në të cilin merrnin pjesë përfaqësues të shteteve të ndryshme evropiane.

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Teuta Sahatqija, duke falënderuar Këshillin Britanik (British Council) për mbledhjen e përfaqësuesve nga shtete të ndryshme, veçanërisht të atyre pesë shteteve të BE-së nga të cilat Kosova pret njohjen e shtetësisë së saj, dha një historik për grupin që ajo udhëheq dhe bëri një përmbledhje të aktiviteteve të tij. Sahatqija, foli posaçërisht, për përfaqësimin gjinor dhe të minoriteteve në Kuvendin e Kosovës, duke e vlerësuar kuotën për gjininë femërore si shumë të rëndësishme për avancimin e demokracisë në Kosovë.

Edhe anëtarët e tjera të grupit, Flora Brovina, Donika Kadaj-Bujupi e Alma Lama, në këtë linjë folën për avancimin e rolit të gruas në shoqërinë dhe jetën politike në Kosovë, por edhe shtruan nevojën për faktorizimin e mëtejme të saj, në mënyrë të veçantë, brenda partive politike. Me tone pozitive u vlerësua edhe përfaqësimi i saj në ekzekutiv, duke filluar me institucionin e Presidentit të vendit, deri te pozitat e zëvendëskryeminstreve dhe në udhëheqje të dikastereve të tjera në Qeverinë e Kosovës.

Përfaqësues të Spanjës, Greqisë, Sllovakisë etj., duke shprehur vlerësimin e tyre pozitiv për përfaqësimin e gruas në institucione, u interesuan edhe për aspekte të tjera të rolit të saj dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje, veçanërisht në sektorin privat, në biznes etj., ndërsa sqarimet e nevojshme i dhanë deputetet pjesëmarrje në takim.



Grupi i Grave Deputete u takua me delegacionin parlamentar nga Suedia

E mërkurë, më 02.11.2011

Grupi i Grave Deputete i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Teuta Sahatqija, kishte sot një takim me delegacionin parlamentar nga Suedia, të kryesuar nga Jonas Gunnarsson, kryetar i PSD-së. Delegacioni nga Suedia u interesua për çështje të pozitës së gruas në shoqëri, si dhe për angazhimet e këtij Grupi në avancimin e pjesëmarrjes së grave në Kuvend dhe në institucione të tjera të vendit. Teuta Sahatqija dhe Donika Kadaj- Bujupi, i bënë një vështrim të gjerë aktiviteteve të Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, si një faktor i rëndësishëm për avancimin e demokracisë në Kosovë. Teuta Sahatqija, në fillim foli për përbërjen e GGD-së, duke theksuar se të gjitha grupet parlamentare kanë anëtarë në këtë Grup, kurse brenda



tij nuk ka ndasi partiake, madje ky është grupi më koheziv, sepse pozita e gruas nuk vështrohet nga përkatësia partiake. Ajo pastaj foli edhe për kuotën e 30 përqindëshit në përbërjen parlamentare, e cila ka reflektim shumë pozitiv në pozitën e grave, kuotë kjo që duhet të ruhet edhe më tutje. Mirëpo, ajo shprehu pakënaqësi lidhur me pjesëmarrjen jo të duhur të grave në organet udhëheqëse, si: në udhëheqjen e komisioneve parlamentare, në Kryesi, si dhe në Qeverinë e Kosovës. Ajo angazhohet, që në çdo strukturë udhëheqëse të përfaqësohet gruaja, në funksion të barazisë gjinore, përkatësisht të thyhen stereotipet se vetëm meshkujt duhet të zgjidhen në pozita udhëheqëse.

Në takim u përmend edhe rasti i universitetit, ku pozitrat rezervohen për burra, megjithëse femrave nuk u mungojnë kualifikimet përkatëse. Donika Kadaj- Bujupi, përmendi edhe kuotën e ulët të pjesëmarrjes së femrës në nivelet lokale të qeverisjes. Ajo në vazhdim tha se te qytetarët vërehet një besim më i madh ndaj femrave me rastin e zgjedhjeve. Gratë po marrin gjithnjë e më shumë vota, nisur edhe nga fakti se ato janë më imune ndaj korrupsionit dhe dukurive të tjera negative. Mysafirët suedezë u njoftuan edhe për aktivitetet shumë të frytshme të GGD-së, në kontakte të vazhdueshme me qytetarë, në debate të ndryshme, pastaj angazhimet në fushata të ndryshme, siç është ajo e luftimit të hershëm të kancerit të gjirit, të aktiviteteve në kuadër të reformës zgjedhore etj. Në këto aktivitete, u tha se gratë deputete përkrahen edhe nga Kryekuvendari, Presidentja, NDI-ja dhe OSBE-ja, por edhe nga kolegët e tyre deputetë e shoqëria civile.

Zonjat, Sahatqija e Bujupi shfaqën kënaqësinë për kontaktin me parlamentarët suedezë, në mesin e të cilëve ishte edhe deputeti Adnan Dibrani, i cili kishte emigruar në Suedi që në fillim të viteve '90-të. Ato theksuan se këtë shtet e shohin si shtet ideal. Në këtë frymë bashkëpunimi edhe delegacioni suedez u shpreh se, me kënaqësi do të priste Grupin e Grave Deputete në vizitë në Suedi.

Takimi i GGD-së me Grupin e Grave të Vushtrrisë

E mërkurë, më 2 nëntor 2011

Grupi i Grave Deputete, në vazhden e takimeve me grupet e grave të komunave të Kosovës, sot u takuan me Grupin e Grave të Vushtrrisë. Në këtë takim, kryetarja e GGD-së, znj. Teuta Sahatqija, foli për punën dhe rolin e rëndësishëm që ka GGD-ja dhe gruaja në procesin e zhvillimit të demokracisë dhe në procesin drejt integritetit në BE, i cili varet edhe nga roli dhe fuqizimi i gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjithë sektorët e shoqërisë. Znj. Sahatqija foli për angazhimet e GGD-së për të përmirësuar me ligj pozitën e gruas, shëndetin e saj, si dhe luftimin e dukurive negative që po e atakojnë gruan, si: dhuna në familje, diskriminimi, trafikimi etj.



Edhe znj. Donika Kada-Bujupi foli për reformën zgjedhore dhe rëndësinë e saj, në mënyrë Kosova të ketë zgjedhje të besueshme dhe demokratike, si dhe rëndësinë e aplikimit të kuotës gjinore legislative në Ligjin zgjedhor në harmoni me Ligjin për barazi gjinore, si dhe rëndësinë e përfshirjes së gruas edhe më tutje në pozita, ku ndikimi i saj është i rëndësishëm dhe në favor të politikave gjinore. Edhe Grupi

i Grave nga Komuna e Vushtrrisë, si dhe kryetarja e këtij Grupi, Gjylsime Feka, shprehën shqetësimet e tyre lidhur me moszbatimin e Ligjit për barazinë gjinore, e madje edhe në një formë të diskriminimit të fshehtë që po ndodh në punësim, apo zgjedhje në pozita më të larta. Në këtë takim u rekomandua që:

- Në Reformën zgjedhore të aplikohet kuota gjinore legislative konform Ligjit për barazinë gjinore.
- Të amendmentohet Ligji për barazi gjinore dhe të rritet zbatueshmëria e tij në mënyrë kualitative.
- Ligji për partitë politike të përfshijë kuotat gjinore të obligueshme, të cilat duhet t'i aplikojnë në aktet normative të tyre.
- Të rritet roli i gruas në kuvendet komunale, duke fuqizuar mekanizmat gjinorë ekzistues, si grupet e grave të komunave, Zyra për barazi gjinore .
- Në politikat arsimore, të përfshihet perspektiva gjinore, si dhe të investohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe intelektuale të grave.

Grupi i Grave Deputete dhe Presidentja, Atifete Jahjaga vizituan shoqatën “Medika” në Gjakovë

E enjte, më 3 nëntor 2011

Sot, Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga znj. Teuta Sahatqija, kryetare dhe Donika Kadaj- Bujupi, anëtare e Bordit, së bashku me Presidenten e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga vizituan shoqatën “Medika” në Gjakovë.

Znj. Presidente shprehu gatishmërinë për t’i dhënë përkrahjen shoqatës dhe grave që kanë pësuar nga lufta, viktimat të dhunës, por edhe grave të tjera në nevojë, të cilat kanë gjetur mbështetje në këtë shoqatë.

Znj. Sahatqija përgëzoi znj. Veprorë Shehu për punën e madhe që ajo dhe shoqata “Medika” po bën në dhënien e ndihmës shëndetësore, juridike dhe psikosociale për këtë kategori grash. Znj. Sahatqija, duke urrear shoqatën dhe anëtarët e saj për punën e mirë që po e bëjnë, theksoi nevojën e stimulimit të veprimtarive ekonomike të grave, në mënyrë që ato të sigurojnë mirëqenie më të madhe për vete dhe familjen. Përkrahja më e mirë dhe më përmbajtësore që mund t’i bëhet gruas, familjes, por edhe shoqërisë, është krijimi i mundësive për fuqizimin ekonomik të gruas.

Znj. Donika Kada- Bujupi, tha se, edhe pse lufta goditi rëndë gruan gjakovare, prapëseprapë ato janë shembull i gruas së fortë që mundi të tejkalojë dhembjen dhe të ndërtojë të ardhmen dhe të japë edhe kontributin e vet në ndërtimin e shtetit.

Znj. Veprorë Shehu, njoftoi Presidenten dhe deputetet për punën dhe të arriturat e shoqatës “Medika”.

Pastaj ato së bashku vizituan Fabrikën e Prodhimit të Qumështit, objekt pothuaj i përfunduar dhe i ndërtuar enkas për grua, i cili me kërkesë të shoqatës “Medikas” u financua nga Gjermania. Presidentja dhe deputetet shprehen gatishmërinë e tyre që të angazhohen që ky objekt me rëndësi për gratë, por edhe ekonominë gjakovare, të finalizohet dhe të fillojë sa më shpejt të funksionojë.



Bordi i Grupit të Grave Deputete vizitoi Institutin e Onkologjisë në Prishtinë

E mërkurë, 09.11.2011

Bordi i Grupit të Grave Deputete, në përbërje: Teuta Sahatqija-kryetare, Flora Brovina, Alma Lama dhe Suzan Novoberdali- anëtare, vizituan sot Institutin e Onkologjisë në Prishtinë. Është kjo vizita e dytë që i bëhet këtij institucioni nga GGD-ja, në kuadër fushatës sensibilizuese kundër kancerit të gjirit. Gratë deputete u pritën nga ana e drejtorisë së këtij Instituti, ndërsa qëllimi i vizitës ishte shikimi i nevojave dhe problemeve, me të cilat ballafaqohet Instituti i Onkologjisë. Vlen të theksohet se Bordi i Grupit të Grave Deputete ka zhvilluar biseda me Presidenten e Kosovës, Atifete Jahjaga dhe me organizata të ndryshme, duke u angazhuar për sigurimin e mjeteve për blerjen e manografëve mobilë për nevoja të këtij institucioni. Teuta Sahatqija shfaqti shpresën se në pjesën e parë të vitit të ardhshëm do të sigurohen këto pajisje. Përfaqësuesit e drejtorisë së këtushme, njoftuan delegacionin e deputeteve se kanë nevojë për 7 mijë protokolle për kimioterapi. Nga udhëheqja e Institutit të Onkologjisë u tha se këtu ndihet nevoja edhe për citostatikë dhe herceptina. Ndërkaq, pritet që në Kosovë të bëhet edhe radioterapia.

Për të ndihmuar këtë institucion, gratë deputete kanë ndërmarrë nismën për t'u angazhuar në rishikimin e buxhetit për Institutin e Onkologjisë, në mënyrë që të krijohen kushte që pacientet kosovare të mos dalin jashtë vendit për mjekim.

Apel i Grupit të Grave Deputete kundër dhunës në familje



Sot, në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, në pikën e 10-të të rendit të ditës, ishte shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Fatkeqësisht, sot në seancë, kësaj teme të rëndë iu bë një trajtim “bajat, numerik, pa prioritet dhe pa shpirt”.

GGD-ja, duke qenë e shqetësuar për këtë dukuri, më 19.10.2011 ka mbajtur një tryezë me këtë temë, në të cilën pjesëmarrëse ishte vetë Presidentja, Atifete Jahjaga, zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, deputetë nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Avokati i Popullit, pjesëmarrës kompetent nga Shërbimi Policor i Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shoqëria civile etj.

GGD duke pasur parasysh se familja është qeliza themelore e shoqërisë, vend ku duhet të mbretëroje dashuria, respekti, dhe ambienti i shëndoshë për rritjen e fëmijëve; nga familja rrjedhin vlerat e një shoqërie, respekti ndaj prindit, mësuesit, respekti ndaj punës, solidariteti, ndershmëria, atdhedashuria; familja multiplikon këto vlera në të ardhmen, përmes fëmijëve të vet të cilët vlerat themelore i marrin pikërisht nga familja.

Për keqardhje, nuk ka në çdo familje ambient të qetë familjar. Fatkeqësisht, edhe ne Kosove ka mjaft familje ku mbretëron ambient i dhunës, mungesë respekti, bile edhe vrasje, rasti i Dianës, e cila u vra në mes të ditës, në mes të qytetit, dhe fatkeqësisht, kjo as që bëri një bujë të madhe. Një jetë njeriu u shua, iu këputën ëndrrat, planet, dhe atë, jo nga një i huaj, por nga ai i cili do të duhej ta donte, ta mbronte nga rreziku. Dhe në anën tjetër, fëmijët mbesin pa nënë dhe pa baba, mbesin që shoqëria të merret me ta. Dhe kuptohet, ata duke qenë në mbrojtjen e askujt kanë predispozita që të bëhen dhunues.

Presim nga deputetët burra, të marrin fjalën dhe të kërkojnë ndalimin e dhunës, sepse është punë e mentalitetit, e përditshmërisë, dhe ne si përfaqësues të popullit, duhet të kërkojmë ndalimin e dhunës.

Grupi i Grave Deputete përgëzon punën e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur për monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në

familje, gjithashtu përgëzon NDI-në për hulumtimin që ka bërë lidhur me këtë Ligj. Duke apeluar që kjo dukuri shqetësuese për familjen të parandalohet, propozon këto rekomandime:

1. Qeveria e Kosovës me qëllim që të realizojë Programin kundër dhunës në familje, të përkrahë ministrinë, OJQ-të, dhe strehimoret që kanë në përgjegjësi trajtimin e dhunës në familje.
2. Ministria e Drejtësisë të hartojnë e Udhëzimin administrativ dhe aktet tjera normative, me qëllim të rritjes së efektivitetit të ligjit dhe po ashtu për këtë çështje të krijohet fond i veçantë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike.
3. Gjykatat t'i trajtojnë rastet e dhunës në familje si raste me prioritet, meqë vonesa e tyre mund të ketë pasoja të paparashikueshme.
4. Institucionet relevante, si: MD-ja, MPMS-ja, MPB-ja, MSH-ja dhe SHPK-ja, të trajtojnë gjyqtarët, kuadrin mjekësor, punëtorët socialë, punëtorët e shërbimit policor, etj., si dhe të sigurohet kuadër i specializuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
5. Në bashkëpunim me MPMS-në, MSH-në, të MAP-në, MPB-në dhe MASHT-in, të ngritin infrastrukturën e nevojshme për mbështetjen dhe plotësimin e nevojave për personat ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje.
6. Policia e Kosovës, t'i përgjigjet në mënyrë adekuate çdo kërkesë për asistencë apo mbrojtje në rastet e dhunës në familje edhe atëherë kur raportuesi i dhunës në familje nuk është viktimë e dhunës në familje.
7. Policia e Kosovës duhet të caktojë të njëjtin prioritet për thirrjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, sikurse që i jep edhe rasteve tjera kriminale.
8. Policia e Kosovës, pas pranimit të thirrjes, të bëjë vlerësimin e rrezikut dhe të përgjigjet në përputhje me rrethanat, të marrë në pyetje viktimën dhe dëshmitarët, përfshirë dhe fëmijët, në dhoma të ndara dhe të sigurojë që delarata të merret lirshëm, si dhe të sigurojë transportimin e viktimave deri në spital, qendrën mjekësore, apo në vend të sigurtë në pajtim me nenin 24 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.
9. Policia duhet të ofrojë mbrojtje për raportuesin e dhunës në familje.
10. MPMS-ja, në bashkëpunim me MASHT-in, të hartojnë program të veçantë për riintegrimin (shkollimin, aftësimin profesional dhe punësimin) e personave të prekur nga dhuna në familje, si dhe të hartojnë program të veçantë për lehtësimin e sigurimit të banimit të përkohshëm (nëse ka mundësi të përhershme) për personat në fjalë konform objektivave që dalin nga Programi i Kosovës kundër dhunës në familje.
11. Ekipi ndërministror mund t'i sugjerojë Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve tjera relevante krijimin e shërbimeve ndihmëse apo shfrytëzimin dhe financimin direkt të viktimave të dhunës në familje dhe atë duke ndërtuar:
 - a) Banesa, apo strehimore të mjaftueshme për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu akomodim të mirë dhe të sigurt, këshilltarë profesionalë si dhe gjetjen e një akomodimi afatgjatë për viktimat e dhunës në familje;
 - b) Qendër këshilluese dhe përkrahëse për viktimat e dhunës në familje, të cilat do të ofronin ndihmë proaktive, përfshirë ndihmën për këshilla juridike.

Reagim i Grupit të Grave Deputete me rastin e propozimit diskriminues të ambasadorëve



Grupi i Grave Deputete shpreh shqetësimin dhe protestën e vet për emrat e kandidatëve për ambasadorë që kanë ardhur sot në Komisionin për Politikë të Jashtme. Kjo listë e ambasadorëve të propozuar, përfshin vetëm meshkuj. Madje, përveç faktit që numri i femrave në listën e ambasadorëve të propozuar është zero (0), tani po shkohet me një politikë minus një (-1), ku edhe një ambasadore femër që ka shërbyer deri tani, po zëvendësohet me një mashkull.

Kjo është shkelje flagrante e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 24 (2) dhe Ligjit për barazi gjinore (neni 3). Në veçanti, neni 3.4 i Ligjit për Barazi Gjinore parasheh që "Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këta këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese".


Gjithashtu, është shkelur Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë sipas nenit 22(6) të Kushtetutës. Për më tepër, kjo krijon një imazh të keq për Kosovën ndërkombëtarisht dhe paraqet shkelje të të drejtave të mbi 50% të popullatës në Kosovës që janë të gjinisë femërore. Kosova ka gra të denja dhe të afta që mund të përfaqësojnë interesat e Kosovës denjësisht dhe t'i japin një imazh modern shtetit tonë të ri.

Grupi i Grave Deputete i bën thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të ndalojë këtë praktikë diskriminuese, dhe po ashtu kërkon nga Komisioni për Politikë të Jashtme në Kuvend dhe nga Presidentja e Republikës së Kosovës, që mos të miratojnë dhe nënshkruajnë këtë propozim diskriminues. Grupi i Grave Deputete nuk do të miratojë këtë listë njëgjimore dhe do të ndërmarrë të gjitha masat ligjore brenda Kuvendit për të ndaluar praktikën diskriminuese që mbi të gjitha nuk marrin parasysh kualitetin.

Me respekt,
Teuta Sahatqija _____
Kryetare e Grupit të Grave Deputete
Kuvendi i Kosovës
Kati -III Nr. N- 319 A
E-mail: woman.caucus@ks-gov.net
woman.caucus@gmail.com
Tel: 038 211 330

TRI ZONJA AMBASADORE, REZULTAT I REAGIMIT TË GGD-së

Pas reagimit të GGD-së, lidhur me listën njëjtinore për ambasadorë të propozuar, GGD-së i ka ardhur një përgjigje nga Ministri i Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj .



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranilh Poslova
Ministry of Foreign Affairs

REF. NR. 212 /11
 DATE : 16.11.20

PËR: Grupin e Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës

PËRMES: Znj. Teuta Sahatqija

NGA: Z Enver Hoxhaj, Ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës

LËNDA: Përgjigje në reagimin lidhur me Propozimet për Ambasadorë


E nderuara Znj. Sahatqija,

Me respekt e pranuar dhe e shqyrtuar reagimin Tuaj në emër të grave deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më lejoni ju lutem që fillimisht të shprehë pajtimin tim se reagimi i Juaj është i drejtë dhe se padyshim kjo çështje është veç duke u konsideruar me seriozitet dhe rëndësi të veçantë në Ministrinë tonë.

Për më tepër dua të ju sigurojë se ne jemi duke përfunduar konsultimet me disa kandidate të mundshme për tu rekomanduar për emërimin e tyre si Ambasadore. Ministria e Punëve të Jashtme pas konsultave dhe verifikimit të plotësisht të kriterëve që përcaktohen me Ligj si dhe në pajtim me procedurat në fuqi do t'i përcjellë rekomandimet e saja për emërimin e Ambasadoreve në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës.

Së dyti, po ashtu më lejoni të ju njoftojë që korniza ligjore në fuqi garanton që Ambasadorët që janë emëruar dhe janë duke shërbyer janë dhe do të mbesin pjesë e Shërbimit të Jashtëm. Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi lëvizjet e ambasadorëve nga një mision në mision tjetër do t'i shërbejnë thellësisht fuqizimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, për të cilin unë edhe kabineti im jemi të përkushtuar dhe po punojmë me intensitet të madh në realizimin e kësaj objekte. Fushëveprimtaria e kornizës ligjore të lartpërmendur, në veçanti Ligji për Ministrinë e

Letra e ministrit, Enver Hoxhaj dërguar GGD-së



Grupi i Grave Deputete vizitoi Parlamentin e Suedisë dhe institucione të tjera të rëndësishme në Stokholm

E mërkurë, 30.11.2011.

Grupi i Grave Deputete vizitoi Parlamentin e Suedisë dhe institucione të tjera të rëndësishme në Stokholm.

Një delegacion i anëtareve të Bordit të Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, zhvilloi një vizitë dyditore në Parlamentin e Suedisë. Delegacioni i Grave Deputete zhvilloi një sërë takimesh të rëndësishme. Ato u pritën edhe nga përfaqësuesi më i lartë i këtij institucioni, Kryetari i Parlamentit Suedez, z. Per Westerberg.

Kryetarja e grupit të Bordit të GGD-së, znj. Teuta Sahatqija e njoftoi kryetarin e Parlamentit të Suedisë me angazhimin e grave deputete për çështje të rëndësishme, si ajo e kuotës në Kuvend dhe asambltë, angazhimin për barazi gjinore edhe në institucione të tjera të Kosovës,



përpjekjet për të instaluar demokracinë në vend, si dhe disa prej aktiviteteve të tjera, me të cilat po merret ky grup. Zoti Westerberg theksoi se në Parlamentin e Suedisë 47% janë gra, ndërsa përbërja e kabinetit qeveritar aktualisht anon nga gratë. Ai theksoi se debati dhe përpjekjet në Suedi kanë të bëjnë me futjen e kuotës gjinore edhe në borde dhe agjenci shtetërore, por edhe në bordet e kompanive private.

Anëtarët e Bordit patën një takim edhe me grupin homolog të grave të Parlamentit të Suedisë, i cili përbëhej nga përfaqësueset e secilës parti dhe që merrej me çështje gjinore. Duke ndarë eksperiencat e përbashkëta, përfaqësueset e të dyja grupeve diskutuan edhe për iniciativat e përbashkëta që mund të sendërtohen në të ardhmen.

Në takimin me fondacionin Kvina til Kvina, (Gratë për gratë), sekretarja e përgjithshme Lena Ag theksoi se eksperiencia e grupit të Grave Deputete të Kosovës do të shërbejë si një model shumë i mirë, i cili do t'iu rekomandohet edhe shumë vendeve të tjera nëpër botë. Anëtarët e bordit, gjatë vizitës në Suedi, zhvilluan takime edhe me përfaqësues të institucionit të Ombudsmanit për barazi gjinore, me të cilët u bisedua se si mund të merret eksperiencia e Suedisë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të grave dhe fëmijëve.

Po kaq i rëndësishëm ishte edhe takimi me institutin Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore, IDEA, i cili është i specializuar për sistemet zgjedhore. Përfaqësuesja e këtij institucioni, znj. Rumbidzai, tha se kuota legislative ka sjellë rezultate të prekshme në Kosovë dhe se tashmë lufta duhet përqendruar në demokratizimin e brendshëm të partive politike. Sipas saj, futja e kuotës gjinore në statutet e partive është domosdoshmëri, jo vetëm në Kosovë, por edhe vende të tjera.

U mbajt tryeza mbi kancerin në gji dhe qafë të mitrës



E premte, 25.11.2011

Bordi i Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me NDI-në, organizoi sot në ambientet e Kuvendit të Kosovës një tryezë mbi kancerin në gji dhe qafë të mitrës. Në këtë tryezë, në të cilën ishte i pranishëm edhe Ferid Agani, ministër i Shëndetësisë, u mbajt në vazhden e shumë aktiviteteve që po ndërmerren GGD-ja me qëllim të inicimit të masave parandaluese në luftimin e kësaj sëmundjeje. Në fjalën e saj, znj. Flora Brovina, moderatore e tryezës dhe znj. Teuta Sahatqija, kryetare e GGD-së, u vu në dukje gatishmëria e GGD-së për përkrahje ligjore të institucioneve shëndetësore, me qëllim që të krijohen kushte të nevojshme për sigurimin e trajtimit të plotë të pacienteve të goditura nga kjo sëmundjeje.

Ministri Agani foli për angazhimin e MSH-së, që shërbimet e diagnostifikimit, trajtimit, por edhe të sensibilizimit, të ngritën në nivel më të lartë. Znj. Sonja Mirakovska, deputete e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, foli për të arriturat e Maqedonisë në luftë kundër kësaj sëmundjeje. Punimeve të tryezës i kontribuan edhe Shqiptar Demaçi, Mejreme Krasniqi, Lumturie Luci, Elvis Ahmedi e Nafije Latifi.

REKOMANDIME

1. Në Ligjin për shëndetësinë, që pritet të amendamentohet, të ketë një amendament të veçantë për kujdesin e shtuar për...apo trajtimin e kancerit të gjirit dhe të qafës së mitrës.
2. Në protokollet ekzistuese, të krijohet një data bazë e numrit të saktë të të prekurve nga kanceri i gjirit dhe qafës së mitrës.
3. Të rritet buxheti për citostatikë e terapi, e cila kushton shumë dhe është e pamundur të sigurohet nga pacientët në këtë situatë ekonomike.
4. Bashkëpunim i ngushtë mes onkologëve, patologëve, gjinekologeve dhe kirurgëve torakalë, kompetent për këto sëmundje, në mënyrë që të ndikohet në zbulimin e hershëm të kancerit me anë të ekzaminimeve adekuate.

5. Rritja e bashkëpunimit midis QKUK-së dhe spitaleve rajonale për mundësi shkëmbimi të kuadrove adekuatë, në mënyrë që mjeku të jetë më afër pacientëve.
6. Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë që të rriten kapacitete për diagnostifikimit të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës si dhe të merren masat ligjore të gjitha format e mundshme të prevenimit, testimit, diagnostifikimit dhe të trajtimit të kësaj sëmundjeje.
7. Qeveria e Kosovës dhe MSH-ja, të shikojë mundësitë e rritjes së kapaciteteve të kuadrit mjekësor me qëllim të trajtimit adekuat të kanceri të gjirit dhe qafës së mitrës dhe karcinomes në tërësi.
8. Të shikohet mundësia që së bashku më OBSH-në apo organizatat ndërkombëtare, të sigurohet vakcina kundër kancerit të gjirit.
9. Të sigurohet mundësia e testimit ambulant (mamografia dhe papa testi).
10. Të sigurohet kuadri inxhinierik për mirëmbajtjen e aparaturave të diagnostifikimit dhe trajtimit.
11. Të organizohen debate, tryeza dhe aktivitete vetëdijësuese me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të sëmundjes sa më herët.

DHJETOR

Grupi i Grave Deputete u takua me Koalicinin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

E premte, 02.12.2011

Sot në Kuvendin e Kosovës, Grupi i Grave Deputete në bashkëpunim me UNICEF-in, u takuan me Koalicinin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Takimin e hapi deputetja, Suzan Novobërdali e cila tha se, edhe pse nuk ka ligj specifik për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Kosova respekton Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, dhe Kuvendi, në veçanti GGD-ja, janë të përkushtuar që të japin përkrahje ligjore dhe institucionale kategorive, e posaçërisht fëmijëve që janë të atakuar nga format e ndryshme të diskriminimit, të dhunës apo kanë mbetur pa familje dhe pa mbrojtje. Ndërsa, deputetja Flora Brovina, e cila po ashtu udhëheq Qendrën për Nënë dhe Fëmijën, theksoi nevojën e bashkëpunimit më të fuqishëm të të gjitha këtyre organizatave, me qëllim që të rritet niveli i mbrojtjes, strehimit dhe mirëqenia e fëmijëve.

Në Takim morën pjesë dhe informuan për angazhimet dhe rolin organizatave të tyre: Johannes Weding, udhëheqës i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Donjeta Kelmendi nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve; Hamjt Dedolli, udhëheqës i Qendrës për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Viktimave (Qendra MVPT), Artur Marku, i deleguar në delegacionin Terre des Hommes; Ibadete Krasniqi, udhëheqëse në "Amici dei Bambini" për Kosovë; Valbona Çitaku, drejtore në "Shpresa për fëmijët e Kosovës" dhe Rudina Ademi-Shala, zyrtare e programit "Save the Children".



Kryetarja e GGD-së, Teuta Sahatqija u takua me drejtoren e Inicativës për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI), Glinka Kapitanova

E premte, më 09.12.2011

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete (GGD) të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Teuta Sahatqija, ka zhvilluar sot një takim me drejtoreshën e Inicativës për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI), nga USAID, Glinka Kapitanova, gjatë të cilit është diskutuar për format e bashkëpunimit, me qëllim të rritjes së efikasitetit në qeverisjen lokale, me theks të veçantë, në forcimin e administratës komunale, fuqizimin e kuvendeve komunale, rritjen e angazhimit të qytetarëve në qeverisjen komunale, përmirësimin e shërbimeve komunale si dhe promovimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Sahatqija njoftoi znj. Kapitanova me përkushtimin e GGD-së për ta fuqizuar rolin e gruas në të gjitha fushat, e sidomos për inkurajimin e grave në nivelin lokal, që të jenë partnerë të barabartë me burrat në ngritjen e nivelit të demokracisë, mirëqenies sociale dhe zhvillimit ekonomik.

Sahatqija dhe Kapitanova u dakorduan që nga viti i ardhshëm të kenë bashkëpunim intensiv me gratë asambleiste të komunave, të OJQ-ve, forumeve të grave etj. Në takim morën pjesë edhe ekspertet e DEMI-it, Melihte Limani e Hanife Limani. UNDP-ja i siguron GGD-së një ekspert për marrëdhënie me publikun 12 dhjetor 2011

Selim Selimi nga UNDP-ja, njoftoi kryetaren e GGD-së, znj. Sahatqija se z. Jeton Rexha do të angazhohet për ta bërë më të dukshme punën dhe angazhimin e GGD-së. Z. Rexha do të fillojë me Buletinin dhe do të vazhdohet me faqen e GGD-së dhe forma të tjera të komunikimit me qytetarë, politikanë, dhe veprimtarë që punojnë për demokracinë në vend dhe jashtë vendit.

Kryekuvendari Krasniqi dhe kryetarja e GGD-së, Teuta Sahatqija morën pjesë në konferencën “Kuota gjinore-përfaqësimi i barabartë për gratë në Kosovë”



E hënë, 12.12.2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, mori pjesë në konferencën “Kuota gjinore-përfaqësimi i barabartë për gratë në Kosovë”, e cila u mbajt në ambientet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Duke iu drejtuar pjesëmarrësve, Kryekuvendari Krasniqi, në fillim tha: “Kam nderin të përshëndes pjesëmarrësit e kësaj konference në emër të Kuvendit të Kosovës dhe në emrin tim dhe të falënderoj Qendrën Kosovare për Studime Gjinore dhe Kvinna till Kvinna për organizimin e mirë që bënë dhe për ftesën që të jemi sot këtu bashkë për të shqyrtuar tema interesante, të rëndësishme dhe aktuale”.

Në vijim, ai tha se trajtimi i çështjeve të barazisë gjinore në Kosovën e aktualitetit historik, nuk ka të bëjë thjesht vetëm me të drejtat e gruas, por me interesin e gjithë shoqërisë dhe vendit, me shfrytëzimin e gjithë potencialit intelektual e profesional në funksion të zhvillimit e të përparimit të gjithmbarshëm. Femrat në shoqëri përbejnë, jo vetëm gjysmën e popullsisë, por edhe gjysmën e potencialit zhvillimor.

“Në të kaluarën jo shumë të largët, gratë në Kosovë përjetonin peshën e dyfishtë të robërisë. Në Kosovën e lirë dhe demokratike, filloi një proces i githanshëm dhe i pakthyeshëm reformash shoqërore, politike dhe ekonomike. Në këtë kuadër, Kuvendi i Kosovës, për të përmirësuar barazinë gjinore dhe përfaqësimin e grave në organin më të lartë legjislativ e përfaqësues, si veprim afirmativ, caktoi një kuotë prej 30%, të pjesëmarrjes së femrave në Kuvend”, theksoi Kryekuvendari Krasniqi.

Në vijim, ai theksoi se qëllimi i kësaj konference është që të debatojmë për përmirësimin dhe avancimin e sistemit zgjedhor në Kosovë. Është i drejtë dhe i qëlluar debati, sepse sistemi zgjedhor nuk mund të jetë çështje vetëm e subjekteve politike, por edhe e shoqërisë civile dhe e publikut. Në këtë frymë, ai shprehu

inkurajimin e shoqërisë civile për të vazhduar kontributin në çështjet gjinore, sepse roli i saj në këtë fushë është i pazëvendësueshëm.

Kosova tashmë, përveç instrumenteve ndërkombëtare për barazinë gjinore, ka edhe legjislacionin e vet dhe programe përkatëse për të eliminuar çfarëdo forme të diskriminimit të gruas dhe barazimin e saj me burrin në të gjitha fushat e jetës. Statusi i gruas në jetën shoqërore, ekonomike e politike të një vendi, si dhe kujdesi për nënën, janë tregues të qartë të emancipimit të vetë shoqërisë dhe të përparimit të vendit. Nuk mund të flitet për kurrfarë procesi të demokratizimit të Kosovës dhe të institucioneve të saj, pa pasur parasysh kriteret e barazisë së gruas me burrin në shoqëri, duke përfshirë këtu edhe barazinë ekonomike, që përbën kushtin sine qua non për emancipimin e gruas.

Barazia gjinore nuk është një dhuratë që u jepet grave nga burrat apo institucionet, ajo përbën të drejtën e ligjshme dhe natyrore të tyre. Gruaja në Kosovë i ka kontribuar emancipimit, përparimit, zhvillimit dhe lirisë së shoqërisë sonë, prandaj i ka siguruar vetës statusin e të barabartit në të. Çështjet gjinore në Kosovë janë institucionalizuar në nivel qendror dhe lokal. Gruaja kosovare është pjesëmarrëse dhe e përfaqësuar në Kuvend, në Qeveri, në pushtetin lokal, në FSK, SHPK, shërbim civil dhe në jetën arsimore, kulturore e shkencore. Megjithatë, roli i gruas në vendim-marrje duhet rritur. Nuk mund të quhet e emancipuar një shoqëri, në qoftë se nuk është e emancipuar gjysma e saj, gjinia femërore.

Gratë e Kosovës e kanë detyrë angazhimin për të drejtat e tyre, por edhe burrat duhet të punojnë për integrimin e balancimit gjinor në çdo fushë të jetës, për respektin reciprok dhe mundësitë e barabarta për të dyja gjinitë, sepse ky është kusht për një shoqëri demokratike dhe të zhvilluar. Çështjet gjinore janë dhe duhet të jenë, jo vetëm për gratë, por edhe për burrat. Në vazhdim kreu i legjislativit të vendit theksoi: "Korniza jonë ligjore, në bazën e së cilës është Ligji për barazinë gjinore, duhet zbatuar dhe avancuar nëpërmjet të një bashkëpunimi të ngushtë midis Kuvendit, Qeverisë dhe shoqërisë civile. Përparimi i barazisë gjinore është një proces global. Dhënia e çmimit Nobel për paqe për këtë vit, pikërisht tri aktivisteve dhe luftëtareve të barazisë gjinore, është një ngjarje e rëndësishme, domethënëse dhe motivuese. Në përfundim, konferencës i uroj punë të suksesshme dhe rekomandime të qarta për institucionet dhe shoqërinë në përgjithësi. Besoj që konferenca do t'u kontribuojë politikave të vendit tonë për përmirësimin e barazisë gjinore dhe të sistemit zgjedhor. Unë dëshiroj të shpreh këtu vullnetin tim për të qenë në mbështetje të barazisë gjinore dhe të ruajtjes e avancimit të përfaqësimit të grave në Kuvendin e Kosovës", u shpreh Kryekuvendari Krasniqi.

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, znj. Teuta Sahatqija, foli për rëndësinë e ruajtjes së kuotës, sepse siç tha ajo, kuota siguron masën kritike të grave të cilat do t'i fuqizojnë gratë nga pozitat më të ulëta dhe do t'i inkurajojë gratë tjera të marrin më shumë rol në shoqëri. Në sistemet natyrore ekziston balanca gjinore, pse mos të ekzistojë ajo edhe në shoqëri.

Në tryezë, me insistimin e znj. Sahatqija, ishte e ftuar enkas ekspertja ndërkombëtare për zgjedhje, prof. Drude Duhlerup, e cila shpjegoi si e kanë gjendjen e përfaqësimit vendet tjera. Ajo theksoi se vendet që pretendojnë të jenë demokratike po aplikojnë kuotën gjinore si masë afirmative. Në diskutim, morën pjesë edhe Luljeta Vuniqi, Igballe Rogova e të tjerë.

Pse gratë kanë nevojë për gratë?

Tryeza, gratë në biznes

E enjte, 15.12.2011

Grupi i Grave Deputete, përkrahur nga NDI-ja, mbajti sot një tryezë për gratë në biznes me temën: “Pse gratë kanë nevojë për gratë, të cilën e kryesoi, anëtarja e Bordit të GGD-së, deputetja Donika Kadaj- Bujupi, e cila foli për gjendjen e rëndë ekonomike, nivelin e lartë të të papunësisë, të varfërisë, si dhe mundësive tepër të kufizuara për të filluar dhe zhvilluar veprimtari ekonomike. Ajo tha se, edhe pse në Kosovë janë të regjistruara rreth njëqind mijë biznese, vetëm gjysma e tyre janë funksionale, ndërsa gratë përbëjnë më pak se 6% të bizneseve të regjistruara.

Kryetarja e GGD-së, znj. Teuta Sahatqija, duke folur për përkushtimin e GGD-së në favor të politikave që nxisin zhvillimin ekonomik të vendit, theksoi vullnetin e madh që kanë gratë për të qenë kontribuuese të buxhetit familjar dhe shtetëror, jo të jenë vetëm shpenzuese, por siç tha ajo, për të arritur këtë duhen politika adekuate.

Në vazhdim të tryezës, ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, foli për rëndësinë e inkurajimit të grave që të merren, jo vetëm me biznese të vogla të manufakturave, por edhe me biznese shumë më të fuqishme, përkatësisht me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat po udhëhiqen nga gratë dhe janë në përgjithësi më me prosperitet. Kryetari i Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Zenun Pajaziti tha se përkrahja e gruas në veprimtarinë afariste është edhe objektiv i mijëvjeçarit (OZHM), ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, theksoi nevojën për partneritet publiko-privat dhe subvencionim të afarizmit të grave. Tryezës i kontribuuan me kumtesat e tyre edhe Cathy Allen, këshilltare ndërkombëtare e NDI-së, shkëlqesia e saj, Sarmite Bulte, anëtare e Këshillit Mbretëror të Kanadasë, Joceline Talbot, këshilltare e Lartë për çështje gjinore- UNDP në Kosovë, Mirlinda Kusari, drejtore e shoqatës “She-Ra” dhe Linda Shala, pronare e Data Projekt Elektronik.



Gratë në Biznes

Rekomandime

1. Përkrahja me ligj e afarizmit të grave dhe të hartohen politika që fuqizojnë ekonomikisht gratë dhe të favorizojnë iniciativat e grave në biznes.
2. Të hartohet strategji kombëtare për gra në biznes.
3. Në universitete të zhvillohen kurrikula në favor të politikave gjinore dhe ekonomike.
4. Të bëhen politika ekonomike dhe fiskale (si kredi me kushte të favorshme, tatime me norma të ulëta etj.), si dhe të subvencionohen aktivitete biznesore të grave në sektorë të ndryshëm.
5. Të shikohet mundësia e krijimit të fondit për zhvillimin e bizneseve të grave.
6. Të themelohet një komisioni që do të vlerësonte dhe përcillte gjendjen dhe vepërimtarinë e bizneseve të grave.
7. Të organizohen e seminare, trajnime apo specializime të ndryshme, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të grave për afarizëm.
8. Qasjen në trajnim në punë, qasjen në fuqinë punëtore apo ritrajnim për hyrje të serishme në fuqinë punëtore bashkë me OJQ-të.
9. Promovimin e grave pjesëmarrëse në industrinë e informatave.
10. Të rritet Partneriteti publiko-privat, me qëllim që të fuqizohet roli i gruas në ekonomi.
11. Të rritet prezenca e grave në bordet e ndërmarrjeve publike.
12. Të nxitet absorbimi i grave nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si në agrobiznes dhe vepërimtari të tjera ekonomike.
13. Të përkrahen gratë kryefamiljare për të filluar apo zhvilluar afarizëm.
14. Të bëhet Platforma për menaxhim të rritjes së fëmijëve, angazhimeve profesionale etj.
15. Të organizohen ekspozita, panaire, publikime dhe forma të promovimit të vepërimtarive afariste të grave.
16. Të bëjmë një fushatë, me qëllim të promovimit dhe konsumimit të produkteve vendore me moton "Duaje tënden".
17. Të fuqizohen mekanizmat ligjorë, me qëllim që të luftohen dukuritë negative që pengojnë zhvillimin e bizneseve, në veçanti të luftohet korrupsioni.

Takimi Sahaçija- Glenski

E enjte, më 29.12.2011

Kryetarja e Grupit të Grave Deputete, znj. Teuta Sahatqija, u takua sot me znj. Karen Glenski, këshilltare ndërkombëtare në OSBE dhe znj. Sabiha Shala, këshilltare lokale në OSBE.

Znj. Sahatqija foli për aktivitetet e GGD-së për ta fuqizuar rolin e gruas, për angazhimin e GGD-së lidhur me mirëqenien, shëndetin, punësimin, arsimimin dhe aspektet tjera të jetës së gruas. Znj. Sahatqija i njoftoi përfaqësueset e OSBE-së lidhur edhe me Strategjinë e GGD-së. Me këtë rast u tha se 40 deputetet e Kuvendit të Kosovës në mbështetje të dispozitave ligjore dhe në pajtim me Acquis communautaire do të mund të bëjnë më tepër për gruan, demokracinë, si dhe për aktivitetet që lidhen me realizimin e objektivave të zhvillimit të mileniumit. Znj. Sahtqija duke i falënderuar për bashkëpunimin e mirë të deritashëm, theksoi nevojën e bashkëpunimit të mëtejshëm me OSBE-në , sidomos në aspektin e fuqizimit të gruas në nivele lokale dhe në fushat tjera.

Znj Glenski shprehu vullnetin e saj dhe të OSBE-së për të vazhduar dhe rritur bashkëpunimin me GGD-në në realizimin e planit dhe objektivave strategjike të GGD-së.

PERIUDHA E KATËRT LEGJISLATIVE -2011-2014



Aferdita Ber-Shaqiri
LDK



Albana Fetoshi
VV



Albana Gashi
VV



Albulena Haxhiu
VV



Alma Lama
VV




Emilija Redzeqi
NDS



Flora Brovina
PDK



Ganimete Musliu
PDK



Hasime Krasniqi
PDK



Hykmete Bajrami
LDK



Lirije Kajtazi
LDK



Lumnije Morina
PDK



Mufera Sinik
KDTP



Myzejene Selmani
KKR



Nazane Breca
LDK



Sevdije Lama
KKR



Suzan Novoberdali
KKR



Teuta Haxhiu
AAK



Teuta Sahatqija
LDK



Time Kadriaj
AAK

PERIUDHA E KATËRT LEGJISLATIVE -2011-2014



Aurora Bakolli
VV



Biserka Kostic
SLS



Blerta Deliu
PDK



Donika K. Bujupi
AAK



Duda Balje
VAKAT



Jasmina Zivkovic
SLS



Jelena Bontic
SLS




Justina Sh. Pula
PDK



Kymete Bajraktari
AAK



Kimete Bytyqi
LDK



Rada Trajkovic
JLS



Rita Hajzeraj-Beqaj
PDK



Safete Hajdergjonaj
PDK



Sala Berisha-Shala
PDK



Salihe Mustafe
PDK



Valbona Dibra
PDK



Vesna Mikic
JSL



Vjollca Krasniqi
LDK



Vjosa Osmani
LDK



Xhevahire Izmaili
PDK









Ky raport është përgatitur nga zyra e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës. Publikimi i këtij raporti është mundësuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI)

